REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 82-të i botimit Nr. 46 (828002) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 20 nëntor 2026



BUXHETI 2027: 76.3 MILIARDË LEKË PËR MBROJTJEN

faqe 3



BASHKËPUNIMI ME FSK-NË DHE GARDËN KOMBËTARE TË NJU XHERSIT, PJESË E RËNDËSISHME E FORMIMIT DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË TRUPËS SË NËNOFICERËVE

Në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN/ANO), në kuadër të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë, Kursit të Avancuar dhe Kursit të Kryekapterit, ku u certifikuan 121 kursantë, mes tyre edhe 6 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Në ceremoni...

faqe 4



22 NËNTORI, DITA KUR SHQIPJA GJETI SHKRONJAT E UNITETIT

Disa data i përkasin historisë, ndërsa të tjera vazhdojnë të jetojnë përmes kujtesës dhe kuptimit që mbartin në të tashmen.22 Nëntori është njëra prej tyre. Është një datë që nuk shënon vetëm përfundimin e një kongresi historik, as vetëm një vendim për mënyrën se si do të shkruhej shqipja. Ajo përfaqëson një nga momentet më të rëndësishme të përpjekjes së shqiptarëve për të bërë gjuhën e tyre një shtyllë të identitetit kombëtar, të arsimit, të kulturës...

faqe 8



"BIG BAND" OSFA, ZËRI ARTISTIK I SHQIPËRISË NË ZAGREB

Një mbrëmje shqiptare në Kroaci, ku muzika u bë urë miqësie dhe takimi me ish-Presidentin Stjepan Mesić solli një moment të veçantë për muzikantët e rinj. Në ditët kur Shqipëria feston dhe përcjell në botë identitetin, kulturën dhe vlerat e saj, arti mbetet një nga mënyrat më të bukura për të treguar se kush jemi. Muzika, veçanërisht, ka një gjuhë që nuk ka nevojë për përkthim. Ajo krijon afërsi, përcjell emocion dhe ndërton ura mes njerëzve e vendeve. Një dëshmi...

faqe 7

MINISTRI NUFI NË FORUMIN SCHUMAN: SIGURIA E PËRBASHKËT KËRKON PARTNERITETE TË BESUESHME DHE VEPRIM KONKRET

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Ermal Nufi, mori pjesë në Edicionin e 3-të të Forumit Schuman për Sigurinë dhe Mbrojtjen, një platformë e nivelit të lartë të Bashkimit Evropian për dialogun politik dhe strategjik mbi sfidat aktuale dhe të ardhshme të sigurisë ndërkombëtare.

Gjatë sesionit plenar me temë "Siguria globale në një mjedis në ndryshim: Partneritete të besueshme për një të ardhme më të sigurt", ministri Nufi theksoi se përballë një realiteti gjeopolitik gjithnjë e më kompleks dhe të paparashikueshëm, angazhimet politike duhet të shoqërohen me bashkëpunim të qëndrueshëm dhe veprime konkrete.

"Në një realitet gjeopolitik gjithnjë e më kompleks dhe të paparashikueshëm, siguria jonë e përbashkët kërkon më shumë se angazhime politike. Ajo kërkon partneritete të besueshme, përgjegjësi të përbashkët dhe veprim konkret", - u shpreh ministri.

Në fjalën e tij, ministri Nufi nënvizoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit transatlantik, të koordinimit NATO-BE dhe të zhvillimit të një mbrojtjeje evropiane që plotëson dhe forcon kapacitetet e Aleancës. Ai theksoi se sfidat e sigurisë nuk mund të trajtohen të shkëputura nga njëratjetra, pasi zhvillimet në hapësirën euroatlantike ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e të gjitha vendeve.





"Nga agresioni rus kundër Ukrainës te sfidat e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, realiteti dëshmon se siguria e vendeve tona është e pandashme", - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Duke riafirmuar angazhimin e Shqipërisë në kuadër të Aleancës dhe bashkëpunimit evropian, Nufi u shpreh se vendi ynë do të vijojë të jetë një aleate e përkushtuar e NATO-s dhe një kontribuuese aktive për paqen dhe stabilitetin rajonal e euroatlantik.

"Shqipëria do të vijojë të jetë një aleate e përkushtuar e NATO-s, një mbështetëse e fortë e bashkëpunimit evropian dhe një kontribuuese aktive për paqen dhe stabilitetin rajonal e euroatlantik", - deklaroi Ministri Nufi.

Edicioni i 3-të i Forumit Schuman për Sigurinë dhe Mbrojtjen u zhvillua në Bruksel, duke mbledhur përfaqësues të nivelit të lartë politik dhe vendimmarrës nga më shumë se 85 vende partnere, përfaqësues të 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, institucioneve të BE-së, organizatave ndërkombëtare e rajonale, si dhe ekspertë të sigurisë, institute kërkimore dhe përfaqësues të botës akademike.

Forumi organizohet nga Shërbimi Evropian për Veprimin e Jashtëm (EEAS) dhe shërben si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e qëndrimeve dhe forcimin e dialogut ndërkombëtar mbi çështjet e paqes, sigurisë dhe mbrojtjes. Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë forum riafirmon angazhimin e saj për bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe për forcimin e sigurisë së përbashkët në hapësirën euroatlantike.

MINISTRI I MBROJTJES ERMAL NUFI: KOSOVA NË NATO, NEVOJË STRATEGJIKE PËR STABILITETIN RAJONAL

Bruksel – Në prag të zhvillimit të Takimit të 37-të të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës (UDCG), në Selinë e NATO-s në Bruksel, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi, zhvilloi një takim me homologun e tij nga Kosova, ministrin e Mbrojtjes, z. Ejup Maqedonci.

Në këtë takim, ministri i Mbrojtjes Nufi riafirmoi mbështetjen e Shqipërisë për aspiratën e Kosovës për anëtarësim në NATO, duke e cilësuar këtë proces si një nevojë strategjike për forcimin e stabilitetit rajonal, parandalimin e konflikteve dhe shmangien e rreziqeve që mund të krijojnë fronte të reja pasigurie në Evropë.

Përmes mesazhit të tij, ministri Nufi theksoi vendosmërinë e Shqipërisë për të mbështetur Kosovën në këtë rrugëtim, në çdo forum dhe në çdo nivel të bashkëpunimit euroatlantik.

"Kosova në NATO është nevojë strategjike për forcimin e stabilitetit rajonal, parandalimin e konflikteve dhe shmangien e rrezikut të hapjes së fronteve të reja të pasigurisë në Europë. Këtë aspiratë, Shqipëria do ta mbështesë me vendosmëri, në çdo forum dhe në çdo nivel të bashkëpunimit euroatlantik. Një NATO më e fortë në Ballkan do të thotë edhe një Europë më e sigurt!", - u shpreh ministri Nufi.

Takimi mes dy ministrave rikonfirmon rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe angazhimin për forcimin e perspektivës euroatlantike të rajonit.

Në kuadër të zhvillimeve të sigurisë në Evropë dhe më gjerë, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve mbeten pjesë e rëndësishme e përpjekjeve për një Ballkan më të qëndrueshëm dhe një hapësirë euroatlantike më të sigurt.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

BUXHETI 2027: 76.3 MILIARDË LEKË PËR MBROJTJEN

Modernizimi i Forcave të Armatosura, në fokus të investimeve, Ministri Nufi: Më shumë kapacitete dhe siguri për vendin

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë pritet të hyjnë gjatë vitit 2027 në një fazë të re të modernizimit dhe forcimit të kapaciteteve operacionale. Projektbuxheti i vitit të ardhshëm parashikon 76.3 miliardë lekë për sektorin e Mbrojtjes, shifër që përfaqëson 2.6% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).

Rritja e investimeve synon forcimin e kapaciteteve mbrojtëse, rritjen e gatishmërisë operacionale të Forcave të Armatosura dhe përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.

Në qendër të planifikimit për vitin 2027 është **modernizimi i pajisjeve dhe sistemeve ushtarake**, me fokus të veçantë në kapacitetet e mbrojtjes ajrore, sistemet e goditjes me precizion, luftën kundër dronëve, kapacitetet ajrore dhe mjetet për përballimin e emergjencave civile.

Sipas projektbuxhetit, ndër sistemet dhe pajisjet që parashikohet të përfshihen në këtë proces modernizimi janë **sistemet HIMARS, dronët luftarakë, sistemet anti-dronë dhe sistemet e mbrojtjes ajrore**, krahas investimeve në avionë krahë-fiksë-, mjete dhe kapacitete të tjera mbështetëse.

Ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, e ka cilësuar këtë projektbuxhet si një hap të rëndësishëm në drejtim të rritjes së kapaciteteve të Forcave të Armatosura dhe garantimit të sigurisë së vendit.

"Kjo do të thotë që Forcat e Armatosura, përmes këtij buxheti, do të pajisen me sisteme moderne: sisteme HIMARS, me dronë luftarakë, me sisteme anti-dronë, me sisteme të mbrojtjes ajrore, me avionë krahëfiksë e me mjete e kapacitete shtesë për emergjencat civile. Kjo do të thotë përmbushje e angazhimeve dhe reformave si një vend anëtar dhe i përkushtuar në NATO. Ky projektbuxhet mundëson më shumë infrastrukturë për mbështetjen e Forcave të Armatosura", – u shpreh ministri Nufi.

Investime për një forcë më të aftë dhe më të gatshme

Financimi i parashikuar për vitin 2027 synon të mbështesë jo vetëm blerjen e sistemeve të reja, por edhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për përdorimin, mirëmbajtjen dhe integrimin e tyre në strukturat ekzistuese të Forcave të Armatosura.

Modernizimi i kapaciteteve do të shoqërohet me forcimin e infrastrukturës ushtarake, rritjen e aftësive për reagim dhe përmirësimin e mbështetjes logjistike e operacionale. Në këtë kuadër, investimet synojnë që strukturat e Forcave të Armatosura të kenë kapacitete më të avancuara për përmbushjen e misioneve të tyre, si në kuadër të mbrojtjes së



vendit, ashtu edhe në përmbushje të detyrimeve dhe angazhimeve të Shqipërisë në NATO.

Një komponent i rëndësishëm i planifikimit lidhet edhe me kapacitetet për emergjencat civile, duke i dhënë Forcave të Armatosura mjete dhe mundësi më të mëdha për të mbështetur autoritetet civile në situata emergjente, fatkeqësi natyrore dhe raste të tjera që kërkojnë ndërhyrje të specializuar.

Shqipëria, më shumë kapacitete në kuadër të NATO-s

Alokimi i **76.3 miliardë lekëve**, ose **2.6% e PBB-së**, e vendos modernizimin e Mbrojtjes në një nga prioritetet kryesore të politikave të sigurisë së vendit për vitin 2027. Investimet e reja synojnë të rrisin ndërveprueshmërinë e Forcave të Armatosura me strukturat aleate dhe të forcojnë kontributin e Shqipërisë në sigurinë kolektive euroatlantike. Përmes pajisjes me sisteme moderne, zhvillimit të infrastrukturës dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore e operacionale, objektivi është ndërtimi i një force më të aftë për t'iu përgjigjur sfidave të reja të sigurisë.

Buxheti i Mbrojtjes për vitin 2027 synon kështu të shërbejë jo vetëm si një instrument financiar, por si një investim strategjik në kapacitetet, gatishmërinë dhe sigurinë kombëtare.

MINISTRI NUFI: SHQIPËRIA, E ANGAZHUAR PËR SIGURINË KOLEKTIVE DHE NJË HAPËSIRË EUROATLANTIKE MË TË SIGURT

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi, mori pjesë në takimin e 37-të të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës **(Ukraine Defence Contact Group – UDCG),** zhvilluar në Selinë e NATO-s, në Bruksel. Në fokus të takimit ishte vijimi i mbështetjes së koordinuar ndërkombëtare për Ukrainën, përballë agresionit rus, si dhe angazhimi i partnerëve për t'i hapur rrugë përfundimit të luftës dhe arritjes së një paqeje të drejtë, të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Nga Brukseli, ministri Nufi theksoi se gjatë këtij takimi u riafirmua rëndësia e vijimit të mbështetjes ndërkombëtare për Ukrainën, duke nënvizuar qëndrimin dhe përgjegjësinë e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.



"Si një anëtare e përgjegjshme e NATO-s, Shqipëria e konsideron këtë si angazhim ndaj vlerave që na bashkojnë, ndaj së drejtës së një kombi për të mbrojtur lirinë dhe sovranitetin e tij, sikurse është një përgjegjësi e vendit tonë ndaj sigurisë kolektive dhe kontributit për një hapësirë euroatlantike më të sigurt", - u shpreh ministri Nufi.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë takim riafirmon angazhimin e vendit tonë në kuadër të sigurisë kolektive dhe mbështetjen për përpjekjet e koordinuara të aleatëve dhe partnerëve ndërkombëtarë në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës.

Takimi i 37-të i Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës u organizua nën kujdesin e ministrit federal të Mbrojtjes së Gjermanisë, Boris Pistorius, dhe Sekretarit Britanik të Shtetit për Mbrojtjen, Wes Streeting.





21 NËNOFICERË CERTIFIKOHEN NË PËRFUNDIM TË KURSEVE PROFESIONALE NË QAPN

Bashkëpunimi me FSK-në dhe Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, pjesë e rëndësishme e formimit dhe zhvillimit profesional të trupës së nënoficerëve

Në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN/ANO), në kuadër të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë, Kursit të Avancuar dhe Kursit të Kryekapterit, ku u certifikuan 121 kursantë, mes tyre edhe 6 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandantë të forcave kryesore dhe reparteve në varësi të Shtabit të Përgjithshëm, komandanti i Forcës Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Mehmet Lladrovci, atasheu ushtarak i Kosovës rezident në Tiranë, nënkolonel Fatbardha Osaj, përfaqësues të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, si dhe drejtues, instruktorë, këshilltarë nënoficerë dhe familjarë të kursantëve.

Gjatë ceremonisë, përshëndetën të pranishmit, komandanti i Kursit të Kryekapterit, kursanti përfaqësues i kurseve dhe komandanti i QAPN-së, kolonel Besim Bala, të cilët vlerësuan rëndësinë e arsimimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve drejtuese dhe profesionale të nënoficerëve.

Në fjalën e tij, komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, vuri në dukje punën e vazhdueshme të stafit pedagogjik dhe të instruktorëve për përditësimin e kurrikulave, programeve dhe leksioneve, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Ai theksoi se njohuritë e përfituara gjatë kurseve u japin nënoficerëve mundësinë të rrisin nivelin e tyre profesional, të marrin përgjegjësi drejtuese në nivele të ndryshme hierarkike dhe të këshillojnë komandantët me aftësi më të zhvilluara menaxhuese.

Gjeneral brigade Kurti vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke u ndalur te vizita studimore në Shkollën e Nënoficerëve të FSK-së, e cila u mundësoi kursantëve njohjen nga afër me organizimin, infrastrukturën dhe detyrat e këtij institucioni arsimor. Ai shprehu mirënjohje për përfaqësuesit e FSK-së për mikpritjen dhe mbështetjen në zhvillimin e aktiviteteve studimore dhe trajnuese në Republikën e Kosovës, duke nënvizuar se bashkëpunimi në arsimimin e trupës së nënoficerëve do të vijojë të thellohet.

Në fjalën e rastit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, vlerësoi organizimin dhe rezultatet e arritura, si dhe kontributin e pedagogëve, instruktorëve dhe personelit mbështetës në formimin profesional të nënoficerëve.

Ai vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit mbi 25-vjeçar me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, aleatët e NATO-s dhe partnerët rajonalë, duke theksuar se arsimimi dhe stërvitja e përbashkët forcojnë profesionalizmin, shkëmbimin e përvojave dhe ndërveprueshmërinë ndërmjet forcave.

Duke u ndalur te zhvillimet e sigurisë në rajon, gjenerallejtënant Kingji theksoi se siguria e Kosovës dhe stabiliteti i Ballkanit Perëndimor janë pjesë e pandashme e sigurisë kombëtare dhe euroatlantike. Në këtë kuadër, ai nënvizoi se mbështetja për zhvillimin profesional të FSK-së kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe të sigurisë rajonale.

Një pjesë të rëndësishme të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm ia kushtoi nevojës për përshtatjen e vazhdueshme të programeve të arsimimit dhe stërvitjes me sfidat e reja të mjedisit të sigurisë. Kërcënimet konvencionale dhe hibride, ekstremizmi, sulmet kibernetike, dezinformimi, sabotimi i infrastrukturës kritike dhe zhvillimi i teknologjive të reja kërkojnë përditësim të vazhdueshëm të njohurive, metodave dhe praktikave stërvitore. Sipas tij, programet duhet të jenë në përputhje me standardet e NATO-s, të përfshijnë mësimet e



nxjerra nga konfliktet dhe përdorimin operacional të sistemeve të reja, ndërsa stërvitja duhet të mbështetet në skenarë sa më pranë realitetit, vlerësim objektiv dhe masa konkrete për përmirësimin e mangësive.

"Synimi është i qartë: arsimim cilësor, stërvitje reale dhe nënoficerë të aftë për drejtimin e trupave. Këtë e kërkon mbrojtja dhe siguria e vendit; këtë e kërkon angazhimi ynë në shkurajimin dhe mbrojtjen kolektive; këtë e kërkon mbështetja e popullsisë në emergjenca civile", - theksoi gjenerallejtënant Kingji.

Duke iu drejtuar kursantëve të certifikuar, ai vlerësoi rolin e nënoficerit si hallkë vendimtare në zinxhirin e komandimit dhe në funksionimin e përditshëm të njësive ushtarake.

"Ju jeni lidhja e përditshme ndërmjet komandantëve dhe ushtarëve. Ju i ktheni urdhrat në veprime, planet e stërvitjes në rezultate dhe përgatitjen individuale në gatishmëri të njësive", - u shpreh ai.

Kursi Bazë, Kursi i Avancuar dhe Kursi i Kryekapterit janë pjesë e procesit të formimit dhe zhvillimit profesional të trupës së nënoficerëve. Kursi Bazë përgatit nëntetarët për rolin e komandantit të skuadrës, Kursi i Avancuar pajis tetarët me aftësitë e nevojshme për detyrën e zëvendëskomandantit të togës, ndërsa Kursi i Kryekapterit synon përgatitjen e nënoficerëve për përgjegjësi në nivele më të larta, deri në atë operacional dhe strategjik.

Ceremonia u përmbyll me mbjelljen simbolike të ullinjve në ambientet e QAPN-së, si shenjë e paqes dhe prosperitetit.

Certifikimi i 121 kursantëve shënon një tjetër hap në përgatitjen e trupës së nënoficerëve, duke forcuar kapacitetet drejtuese dhe profesionale të Forcave të Armatosura, si dhe bashkëpunimin me partnerët dhe aleatët. Formimi i nënoficerëve të aftë për të drejtuar, këshilluar dhe përballuar sfidat e reja mbetet një element thelbësor për gatishmërinë operacionale dhe përmbushjen e misionit të Forcave të Armatosura.



PAS 50 VITESH, SËRISH BASHKË NË OBORRIN E SHKOLLËS “SKËNDERBEJ”

Një takim me kujtesën, miqësinë dhe vitet e rinisë në Garnizonin “Skënderbej”

Ka takime që organizohen për t’u parë pas shumë kohësh dhe ka të tjera që lindin nga një nevojë më e thellë: të rikthehesh te vendi ku ke lënë një pjesë të jetës. I tillë ishte takimi i ish-nxënësve të klasës IV/2 të Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”, të cilët, pas pesë dekadash, u mblodhën sërish së bashku me rastin e 50-vjetorit të maturës.

Në mjediset e Garnizonit “Skënderbej”, aty ku dikur kaluan vitet e rinisë, të formimit dhe të ëndrrave të tyre për t’i shërbyer vendit me uniformë, ish-skënderbegasit u rikthyen jo thjesht si ish-nxënës, por si njerëz që mbartin me vete një histori të përbashkët.

Takimi u organizua nga Shoqata “Shkolla Ushtarake Skënderbej”, në një atmosferë të mbushur me emocione, kujtime dhe respekt për rrugëtimin e përbashkët. Pesëdhjetë vite kishin kaluar nga dita kur ata kishin përfunduar shkollën, por koha dukej sikur ishte ndalur përballë kujtimeve që lidhen me bankat e shkollës, uniformën, shoqërinë dhe vitet e formimit.

Takimi nisi me nderim për ata që nuk u kthyen

Pjesa e parë e aktivitetit ishte edhe më e ndjerë. Takimi nisi me vendosjen e një kurore me lule pranë lapidarit kushtuar 11 studentëve dhe oficerëve të Shkollës së Bashkuar, të cilët ranë heroikisht në krye të detyrës, dëshmorë të atdheut.

Në heshtjen përpara lapidarit, kujtimet morën një tjetër kuptim. Për ata që u rikthyen pas pesëdhjetë vitesh, nderimi i të rënëve nuk ishte thjesht një moment ceremonial. Ishte një përkulje përpara historisë së brezit të tyre, përpara bashkëmoshatarëve dhe njerëzve të uniformës që nuk patën mundësinë të jetonin vitet që erdhën më pas.

Lulet e vendosura pranë lapidarit përcollën një mesazh të thjeshtë, por të fuqishëm: koha mund të kalojë, por kujtesa nuk duhet të zbehet.

Përpara emrave të skalitur në gur, ish-skënderbegasit kujtuan edhe një herë se pas historisë së një shkolle qëndrojnë njerëz, jetë, sakrifica dhe histori individuale që bëhen pjesë e kujtesës kolektive.

Rikthimi aty ku nisi gjithçka

Pas momentit përkujtimor, ish-nxënësit vijuan vizitën në mjediset e Garnizonit “Skënderbej”, duke rikthyer hapat në vendet ku kishin kaluar disa nga vitet më të rëndësishme të jetës së tyre.

Dikur kishin hyrë në këto ambiente si djem të rinj, me ëndrra, ambicie dhe dëshirën për t’u formuar si ushtarakë. Sot, pesëdhjetë vite më pas, u rikthyen me flokë të thinjur, me përvojën e një jete të tërë dhe me një bagazh kujtimesh që koha nuk kishte mundur ta fshinte.

Çdo mjedis sillte një kujtim. Një korridor, një oborr, një hapësirë ku dikur zhvillohej aktiviteti i përditshëm, mjaftonin për të rikthyer në bisedë episode të harruara, emra shokësh, pedagogë e komandantë, orët e mësimit, stërvitjet, disiplinën e jetës ushtarake dhe, mbi të gjitha, shoqërinë e krijuar në ato vite.

Ata nuk po vizitonin thjesht një garnizon. Po riktheheshin në një pjesë të rinisë së tyre.

Dikur, në këto ambiente, koha dukej e gjatë. Pesëdhjetë vite më pas, ajo dukej sikur kishte kaluar në një çast.

Një klasë, një brez, një histori

Takimi i klasës IV/2 ishte edhe një dëshmi e forcës së lidhjeve të krijuara në vitet e shkollës. Në jetën e çdo njeriu ka periudha që nuk përsëriten më. Vitet e shkollës janë ndër to. Por për ish-skënderbegasit ato vite kanë një peshë të veçantë, sepse ishin vite formimi, disipline, sakrifice dhe përgatitjeje për një profesion që kërkonte përgjegjësi dhe përkushtim.

Në atë klasë u formuan miqësi që i rezistuan kohës. Secili mori rrugën e vet, ndërtoi jetën dhe karrierën, përjetoi gëzime e vështirësi, por kujtimi i klasës dhe i shkollës mbeti një pikë e përbashkët referimi.

Pas pesëdhjetë vitesh, ata u ulën sërish pranë njëri-tjetrit, tashmë me një tjetër perspektivë mbi jetën.

Në bisedat mes tyre nuk munguan kujtimet e viteve të rinisë, por as reflektimi mbi rrugën që secili kishte bërë. Emrat e shokëve që mungonin u përmendën me respekt. Kujtimet për ta u bënë pjesë e natyrshme e këtij takimi.

Sepse një klasë nuk është vetëm një listë emrash. Është një pjesë e historisë së secilit.









Shkolla që i bashkoi dhe kujtesa që i riktheu

Për Shoqatën “Shkolla Ushtarake Skënderbej”, takime të tilla kanë një rëndësi të veçantë. Ato nuk shërbejnë vetëm për të mbajtur gjallë lidhjet mes ish-skënderbegasve, por edhe për të ruajtur kujtesën e një institucioni që ka lënë gjurmë në historinë e arsimit dhe të formimit ushtarak shqiptar.

Shkolla Skënderbej ishte më shumë se një institucion arsimor. Për breza të tërë, ajo ishte vendi ku të rinj u formuan në dije, disiplinë, përgjegjësi dhe ndjenjë shërbimi.

Pikërisht për këtë, kthimi në mjediset e saj ka një simbolikë të veçantë. Është kthim te rrënjët, te vendi ku nisi një rrugëtim që për shumë prej tyre do të vazhdonte në Forcat e Armatosura dhe në detyra të ndryshme në shërbim të vendit.

Pesëdhjetë vite më pas, kujtimet janë ende aty

Në fund të takimit, mbeti ndjesia se pesëdhjetë vite nuk kishin qenë të mjaftueshme për të larguar kujtimet. Ato ishin ende aty: në oborrin e shkollës, në mjediset e garnizonit, në emrat e shokëve, në historitë që u treguan sërish dhe në emocionin e një grupi njerëzish që, edhe pas gjysmë shekulli, vazhdojnë ta ndiejnë veten pjesë të së njëjtës klasë dhe të së njëjtës histori.

Takimi i klasës IV/2 nuk ishte thjesht një përvjetor mature. Ishte një udhëtim pas në kohë. Një mundësi për të parë se çfarë kishte mbetur pas pesëdhjetë vitesh dhe për të kuptuar se disa lidhje nuk maten me vite.

Ato maten me kujtime.

Dhe për ish-skënderbegasit, një nga kujtimet më të forta mbetet pikërisht ajo shkollë ku dikur nisën rrugët e tyre: Shkolla “Skënderbej”.

Pesëdhjetë vite më pas, ata u kthyen sërish aty.
Jo më si nxënës.
Por si dëshmitarë të një kohe, të një brezi dhe të një historie që vazhdon të jetojë në kujtesën e tyre.

Forca Ajrore zhvillon garën “Ushtari/Nënoficeri më i mirë 2026”

Forca Ajrore zhvilloi garën **“Ushtari/Nënoficeri më i mirë 2026”**, një aktivitet tashmë i kthyer në traditë të përvitshme, që synon të evidentojë nivelin e përgatitjes profesionale dhe fizike të efektivëve, si dhe të promovojë frymën e konkurrencës së shëndetshme në radhët e trupës. Gjatë garës, ushtarët dhe nënoficerët e Forcës Ajrore u përballën në disa disiplina, duke vënë në provë **njohuritë profesionale, aftësitë fizike, qëndrueshmërinë, disiplinën dhe bashkëpunimin në grup**.

Ky aktivitet shërben si një mundësi e rëndësishme për të identifikuar dhe vlerësuar efektivët më të përgatitur, duke nxitur njëkohësisht motivimin, përkushtimin dhe rritjen e vazhdueshme profesionale të personelit.



Procesi konkurrues zhvillohet fillimisht në nivelin e çdo Force, ku përzgjidhen garuesit më të mirë, të cilët vijojnë më tej konkurrimin në nivelin e **Forcave të Armatosura**, për titullin **“Ushtari/Nënoficeri më i mirë i FA për vitin 2026”**.

Gara e zhvilluar në Forcën Ajrore u përmbyll me ceremoninë e vlerësimit të garuesve më të mirë, duke nderuar përkushtimin dhe rezultatet e tyre gjatë gjithë procesit konkurrues.

Në këtë aktivitet u evidentuan edhe një herë vlerat që karakterizojnë efektivët e Forcës Ajrore: **disiplina, profesionalizmi, përgatitja, përkushtimi dhe gatishmëria për të përballuar çdo sfidë**.

Për Forcën Ajrore, kjo garë përbën jo vetëm një konkurrim sportiv e profesional, por edhe një instrument për forcimin e standardeve të përgatitjes dhe për ndërtimin e një trupe gjithnjë e më të aftë dhe të motivuar.







Nga figura e partizanit te kujtesa e një kombi, nga fitorja mbi fashizmin te përgjegjësia për ta mbrojtur lirinë sot

Monumenti "Partizani fitimtar" realizuar nga skulptori i shquar shqiptar Odhise Paskali, në vitin 1968

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



ÇLIRIMI, KUJTESA E NJË SAKRIFICE, PËRGJEGJËSIA E NJË BREZI

Në historinë e një populli ka data që nuk i përkasin vetëm kohës kur kanë ndodhur. Ato mbeten gjatë në ndërgjegjen kombëtare, sepse pas tyre qëndrojnë jetë njerëzore, sakrifica dhe një ideal që kapërcen brezat. Çlirimi është një prej këtyre momenteve.

Sa herë që afrohen ditët e nëntorit, Shqipëria kthehet te një nga faqet më të rëndësishme të historisë së saj. Jo për të jetuar me të kaluarën, por për të kuptuar më mirë të tashmen. Jo për të përsëritur fjalët e një kohe tjetër, por për të kujtuar çfarë vlere ka liria kur ajo është fituar me sakrificë.

Në këtë kujtesë kombëtare, historia nuk është vetëm një varg datash. Ajo është fytyra e njerëzve që luftuan, zëri i familjeve që pritën, dhimbja e atyre që nuk u kthyen dhe shpresa e një vendi që kërkonte të jetonte i lirë.

Prandaj, festat e Çlirimit nuk janë vetëm ditë përkujtimore. Ato janë një moment për të menduar se çfarë trashëguam dhe çfarë po u lëmë atyre që vijnë pas nesh.

Dhe sot, shumë vite pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, pyetja nuk është vetëm se çfarë ndodhi atëherë.

Pyetja është: **çfarë kuptimi ka për ne sot ajo që ndodhi?**

Sepse historia merr vlerë jo vetëm kur kujtohet, por kur kuptohet.

Dhe liria merr kuptim jo vetëm kur fitohet, por kur ruhet.

Prandaj, në ditët e Çlirimit, vëmendja nuk duhet të ndalet vetëm te ceremonia. Duhet të shkojë te kuptimi.

Sepse një komb që harron sakrificën mbi të cilën është ndërtuar liria e tij, rrezikon të mos e kuptojë më vlerën e asaj lirie.

Çlirimi i Shqipërisë nuk është vetëm një ngjarje e së kaluarës. Është një pjesë e rëndësishme e kujtesës kombëtare. Është një moment që duhet të na bëjë të reflektojmë mbi atë që do të thotë atdheu, sakrifica dhe detyrimi ndaj brezave që vijnë.

Historia nuk shkruhet vetëm nga fitoret.

Shkruhet nga njerëzit që patën guximin të përballeshin me kohën e tyre.

Dhe pikërisht këtu qëndron edhe vlera e kujtesës.

TË MOS E KTHEJMË HISTORINË NË CEREMONI

Me kalimin e viteve, çdo brez e sheh historinë nga një largësi tjetër.

Ata që e përjetuan luftën e dinin se çfarë do të thoshte të mos ishe i lirë. Për brezat që erdhën më pas, liria u bë pjesë e jetës së përditshme. Për brezat e rinj, lufta është gjithnjë e më shumë një kapitull historie, i mësuar në libra dhe i treguar nga gjyshërit.

Kjo është e natyrshme.

Por pikërisht këtu nis përgjegjësia e kujtesës.

Sepse ajo që për brezin e parë ishte përvojë, për brezat pasues duhet të bëhet ndërgjegje.

Nuk mund t'u kërkojmë të rinjve të ndiejnë një luftë që nuk e kanë jetuar. Por mund t'u mësojmë të kuptojnë çfarë solli ajo luftë, çfarë kushtoi liria dhe pse paqja nuk duhet marrë kurrë si diçka e vetëkuptueshme.

Kjo është mënyra më e drejtë për ta përcjellë historinë.

Jo duke e kthyer atë në slogan.

Jo duke e përdorur për ndarje.

Jo duke e lënë të burgosur në ceremonitë e përvitshme.

Por duke e kthyer në mësim qytetar.

Në ndërgjegje kombëtare.

Në respekt për jetën dhe lirinë.

Në këtë kuptim, edhe një vepër arti mund të bëhet një pikënisje për një reflektim të madh. Një figurë e vendosur në një hapësirë të lidhur me një prej tragjedive më të mëdha të shekullit XX na kujton se historia shqiptare nuk qëndron e shkëputur nga historia evropiane.

Dhe kjo është e rëndësishme.

Sepse kujtesa kombëtare nuk zvogëlohet kur vendoset në kontekstin evropian.

Përkundrazi, ajo merr një kuptim më të gjerë.

LIRIA KA NJË ÇMIM

Sot flasim për lirinë me fjalë të zakonshme.

Liria për të menduar.

Liria për të folur.

Liria për të zgjedhur.

Liria për të jetuar në vendin tënd.

Por për brezin që përjetoi pushtimin, këto nuk ishin koncepte abstrakte.

Ishin arsye për të luftuar.

Ishin arsye për të sakrifikuar.

Ishin arsye për të mos u dorëzuar.

Prandaj, kur përkujtojmë Çlirimin, nuk mjafton të themi se një epokë përfundoi. Duhet të kujtojmë se çfarë kishte përpara saj dhe çfarë u desh për të arritur deri te ajo ditë.

Liria nuk është dhuratë.

Ajo është rezultat i sakrificave të njerëzve dhe i përpjekjeve të brezave.

Dhe çdo brez e ka mënyrën e vet për ta mbrojtur.

Për ata që luftuan dje, detyra ishte përballja me pushtuesin.

Për brezat që erdhën më pas, detyra ishte rindërtimi i vendit.

Për brezin e sotëm, detyra është ta ruajë lirinë, paqen, sigurinë dhe dinjitetin e vendit në një botë që ka ndryshuar rrënjësisht. Kjo është arsyeja pse kujtimi i Çlirimit nuk duhet të jetë një kthim mekanik pas në histori.

Ai duhet të jetë një pyetje për të tashmen:

Çfarë po bëjmë ne me lirinë që trashëguam?

BREZAT NDRYSHOJNË, PËRGJEGJËSIA MBETET

Koha ka ndryshuar.

Edhe mënyra se si mbrohet një vend ka ndryshuar.

Sot siguria nuk lidhet vetëm me kufijtë tokësorë. Ajo lidhet me hapësirën ajrore, detin, sigurinë kibernetike, infrastrukturën kritike, informacionin, kërcënimet hibride dhe aftësinë për të bashkëpunuar me aleatët.

Por, pavarësisht ndryshimit të kohëve, një parim mbetet i njëjtë:

Atdheu ka nevojë për njerëz që janë të gatshëm t'i shërbejnë.

Kjo është një nga lidhjet më të rëndësishme që mund të vendosim mes brezit që luftoi për Çlirimin dhe atyre që sot mbajnë uniformën.

Nuk është lidhje e formës.

Është lidhje e misionit.

Partizani i dikurshëm dhe ushtari i sotëm nuk jetojnë në të njëjtën kohë, nuk përballen me të njëjtat rreziqe dhe nuk kanë të njëjtat mjete. Por të dy i përgjigjen një pyetjeje themelore: **çfarë do të thotë t'i shërbesh vendit?**

Në këtë pyetje qëndron edhe vazhdimësia e një kombi.

Sepse brezat nuk trashëgojnë vetëm tokën. Trashëgojnë edhe kujtesën. Trashëgojnë vlerat. Trashëgojnë përgjegjësinë.

KUJTESA NUK ËSHTË VETËM PËR TË SHKUARËN

Ka një arsye pse monumentet, fotografitë, dokumentet, librat dhe dëshmitë e historisë vazhdojnë të kenë rëndësi.

Sepse koha ka një forcë të rrezikshme: **ajo zbeh kujtesën.**

Me kalimin e viteve, njerëzit që e kanë jetuar një ngjarje largohen. Pastaj largohen edhe ata që e kanë dëgjuar prej tyre. Dhe një ditë, një histori që dikur ishte jetë, mund të mbetet vetëm një paragraf në tekstet shkollore.

Kjo nuk duhet të ndodhë me kujtesën e Çlirimit. Jo sepse historia duhet të mbetet e ngrirë. Por sepse një shoqëri pa kujtesë e ka më të vështirë të kuptojë veten.

Ne nuk mund ta ndryshojmë të kaluarën. Por mund të zgjedhim mënyrën se si e kujtojmë atë. Mund ta kujtojmë me respekt. Mund ta studiojmë me përgjegjësi.

Mund t'ua përcjellim brezave të rinj pa deformime dhe pa e humbur thelbin e saj njerëzor.

Dhe mbi të gjitha, mund të nxjerrim prej saj një mësim të thjeshtë: paqja është shumë më e çmuar për ata që e kanë njohur luftën.

NJË KOMB QË DI TË KUJTOJË, DI EDHE TË SHOHË PËRPARA

Festat e Çlirimit janë ditë krenarie, por edhe ditë serioziteti:

Krenarie për ata që u përballën me një prej periudhave më të vështira të historisë;

Seriozitet sepse çdo brez duhet të kuptojë se liria nuk është një trashëgimi që merret dhe harrohet. Ajo duhet mbrojtur, me shtet të fortë, me institucione të përgjegjshme, me qytetarë që e duan vendin e tyre, me arsim që e njeh historinë, me kulturë që e ruan kujtesën dhe me një ushtri që është e aftë të mbrojë vendin dhe të përmbushë detyrimet e saj ndaj aleancave.

Me një shoqëri që e kupton se patriotizmi nuk është vetëm fjalë e bukur në ditë festash, por përgjegjësi në çdo ditë të vitit.

Ndoshta ky është edhe mesazhi më i rëndësishëm që mund të marrim sot nga një vepër e krijuar dekada më parë dhe që vazhdon të qëndrojë si dëshmi e një epoke.

Jo të kthehemi pas. Por të mos harrojmë nga vijmë. Jo të jetojmë me luftën. Por të kuptojmë vlerën e paqes. Jo të trashëgojmë vetëm emrat e atyre që ranë. Por të trashëgojmë përgjegjësinë për të cilën ata sakrifikuan.

ÇLIRIMI ËSHTË KUJTESË, LIRIA ËSHTË PËRGJEGJËSI

Në ditët kur Shqipëria përkujton Çlirimin, le të mos mbetemi vetëm te ceremonia.

Le të mendojmë për njeriun.

Për familjen.

Për sakrificën.

Për frikën e kapërcyer.

Për shpresën që mbijetoi.

Për një brez që besoi se vendi i tij duhej të ishte i lirë.

Dhe le ta shohim këtë kujtesë jo si një peshë të së kaluarës, por si një amanet për të ardhmen.

Sepse koha ndryshon, brezi ndryshon, mjetet ndryshojnë, rreziqet ndryshojnë, por atdheu mbetet dhe bashkë me të mbetet edhe detyrimi për ta dashur, për ta mbrojtur dhe për ta bërë më të mirë.

Në një kohë kur bota përsëri përballet me konflikte, tensione dhe pasiguri, kujtimi i Çlirimit merr një domethënie edhe më të madhe.

Na kujton se paqja nuk është dobësi.

Na kujton se liria nuk është e garantuar përgjithmonë.

Na kujton se një shoqëri duhet të jetë e gatshme ta mbrojë atë që ka fituar.

Dhe mbi të gjitha na kujton se historia nuk jeton vetëm në libra, në monumente apo në muze. Ajo jeton në mënyrën se si ne sillemi me lirinë që kemi trashëguar.

Prandaj, në këto ditë përkujtimi, le të nderojmë ata që ranë. Le të respektojmë ata që luftuan. Le t'ua tregojmë historinë të rinjve.

Dhe le ta kthejmë kujtesën në përgjegjësi.

Sepse Çlirimi është historia e një fitoreje, por Liria është detyra e çdo brezi.



"BIG BAND"

OSFA, ZËRI ARTISTIK I SHQIPËRISË NË ZAGREB

*Një mbrëmje shqiptare në Kroaci, ku muzika u bë urë miqësie dhe takimi me **ish-Presidentin Stjepan Mesić** solli një moment të veçantë për muzikantët e rinj.*

Në ditët kur Shqipëria feston dhe përcjell në botë identitetin, kulturën dhe vlerat e saj, arti mbetet një nga mënyrat më të bukura për të treguar se kush jemi. Muzika, veçanërisht, ka një gjuhë që nuk ka nevojë për përkthim. Ajo krijon afërsi, përcjell emocion dhe ndërton ura mes njerëzve e vendeve.

Një dëshmi e kësaj ishte edhe prania e **Big Band – OSFA** në Zagreb, në aktivitetin zyrtar të organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kroaci, më 17 nëntor 2026, me rastin e **Festës Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.**

Në praninë e trupit diplomatik, përfaqësuesve të Parlamentit kroat, deputetëve dhe anëtarëve të komunitetit shqiptar në Kroaci, muzikantët shqiptarë sollën një program të përzgjedhur artistik, duke e kthyer mbrëmjen në një moment të rëndësishëm të përfaqësimit kulturor të Shqipërisë. Por kjo nuk ishte vetëm një mbrëmje koncertale. Ishte një takim i Shqipërisë me miqtë e saj në Kroaci përmes muzikës.

Ishte një mundësi që talenti dhe profesionalizmi i të rinjve shqiptarë të dëshmonin se kultura është një nga mënyrat më të fuqishme për të ndërtuar marrëdhënie, respekt dhe miqësi mes vendeve.

Pjesëmarrja e Big Band – OSFA u realizua me ftesë të **Ambasadores së Republikës së Shqipërisë në Kroaci, znj. Donika Hoxha,** duke i dhënë kësaj mbrëmjeje edhe një dimension të veçantë të diplomacisë kulturore shqiptare.

Kur muzika bëhet përfaqësim

Në një aktivitet të karakterit zyrtar, muzika nuk është thjesht pjesë e programit. Ajo është edhe përfaqësim. Çdo tingull që interpretohet jashtë vendit mbart me vete një pjesë të kulturës së vendit nga vjen. Çdo artist që ngjitet në skenë bëhet, në një farë mënyre, ambasador i kulturës së tij. Kjo ishte edhe një nga vlerat e pranisë së Big Band – OSFA në Zagreb.

Përmes një repertori që ndërthur traditën me muzikën moderne, grupi solli një Shqipëri që ruan lidhjen me rrënjët e veta, por që njëkohësisht është e hapur ndaj zhvillimeve bashkëkohore dhe komunikimit kulturor evropian.

Interpretimi i tyre i dha aktivitetit një dimension artistik të veçantë, duke dëshmuar nivelin e përgatitjes dhe profesionalizmin e muzikantëve shqiptarë.

Për komunitetin shqiptar në Kroaci, kjo prani kishte edhe një vlerë emocionale.

Të dëgjosh muzikën e vendit tënd larg atdheut nuk është thjesht një përvojë artistike. Është edhe një mënyrë për t'u afruar me kujtesën, gjuhën, kulturën dhe identitetin.

Në këtë kuptim, skena e Zagrebit u bë për një mbrëmje një hapësirë ku Shqipëria u takua me shqiptarët e saj jashtë vendit, por edhe me miqtë kroatë që ndanë me ta këtë festë.

Një takim që mori ngjyrën e miqësisë

Mes momenteve të kësaj vizite, një vend të veçantë zuri takimi i muzikantëve të **Big Band – OSFA** me **ish-Presidentin e Republikës së Kroacisë, Stjepan Mesić.**

Takimi me një prej figurave të njohura të jetës politike dhe publike kroate solli një dimension tjetër në këtë vizitë. Por ajo që e bëri veçanërisht të ngrohtë këtë moment ishte qasja e Mesić ndaj të rinjve shqiptarë.

Në takimin me muzikantët e Big Band – OSFA, ai shfaqi interesim dhe afeksion të veçantë për të rinjtë shqiptarë dhe për atë që ata përfaqësonin përmes artit të tyre.

Nuk ishte thjesht një takim formal. Ishte një komunikim mes brezash, kulturash dhe përvojash. Ish-Presidenti kroat u njoh nga afër me muzikantët dhe me performancën e tyre, duke treguar interes për rrugëtimin e tyre artistik dhe për mënyrën se si të rinjtë shqiptarë po përfaqësojnë vendin e tyre përmes muzikës. Në këtë takim u ndie qartë edhe një element që e kapërcen protokollin: vlerësimi për të rinjtë dhe besimi te potenciali i tyre. Dhe ndoshta ky është një nga mesazhet më të bukura që mund të përcjellë një aktivitet i tillë. Një vend nuk përfaqësohet vetëm përmes institucioneve. Ai përfaqësohet edhe përmes njerëzve të tij. Përmes artistëve. Përmes të rinjve. Përmes talentit dhe punës së tyre.

Kur një figurë me përvojën dhe kontributin publik të Stjepan Mesić ndalet për të komunikuar me të rinjtë shqiptarë dhe tregon interes për atë që ata bëjnë, ky moment merr një kuptim që shkon përtej një fotografie apo një takimi ceremonial. Ai bëhet një vlerësim për brezin e ri dhe për rolin që ai mund të luajë në marrëdhëniet mes dy vendeve.

Të rinjtë shqiptarë, një kartë e bukur përfaqësimi

Në kohën e sotme, diplomacia nuk zhvillohet vetëm në tryezat e konferencave dhe në takimet zyrtare.

Ajo zhvillohet edhe në skena, në galeri, në universitete, në festivale, në aktivitete kulturore, në çdo hapësirë ku njerëzit e vendeve të ndryshme kanë mundësi të njihen me njëri-tjetrin. Dhe pikërisht këtu qëndron rëndësia e pranisë së Big Band – OSFA në Zagreb. Muzikantët shqiptarë nuk shkuan vetëm për të interpretuar. Ata shkuan për të përfaqësuar. Dhe përfaqësimi përmes artit është një nga format më të fuqishme të komunikimit ndërkombëtar. Një performancë e mirë mund të krijojë emocion aty ku fjalët ndonjëherë mbeten të pamjaftueshme. Një artist i ri mund të bëjë të njohur vendin e tij përmes një talenti që nuk njeh kufij. Një grup muzikor mund të krijojë miqësi aty ku një mesazh diplomatik mund të







tingëllojë më formal.

Kjo është edhe arsyeja pse investimi te të rinjtë dhe te arti nuk është vetëm investim kulturor. Është investim në imazhin e vendit. Në mënyrën se si Shqipëria prezantohet jashtë kufijve. *Në mënyrën se si brezi i ri ndërton marrëdhënie me botën.*

Një Shqipëri që dëgjohet përmes muzikës

Mbrëmja e 17 nëntorit në Zagreb ishte një tjetër dëshmi se kultura shqiptare ka shumë për të thënë në hapësirën evropiane.

Në një kohë kur marrëdhëniet mes vendeve ndërtohen gjithnjë e më shumë edhe përmes komunikimit kulturor, prania e artistëve shqiptarë në aktivitete ndërkombëtare merr një rëndësi të veçantë.

Big Band – OSFA solli në Zagreb një Shqipëri që nuk prezantohet vetëm përmes historisë dhe traditës, por edhe përmes energjisë së brezit të ri.

Një Shqipëri që di të ruajë identitetin e saj dhe njëkohësisht të komunikojë me gjuhën universale të artit - kjo është një vlerë që meriton të nënvizohet. Sepse në skenën ndërkombëtare nuk mjafton të flasësh për një vend. Duhet ta bësh atë të ndihet. Dhe muzika ka pikërisht këtë fuqi. Ajo mund të sjellë një emocion shqiptar në zemër të Zagrebit. Mund të bëjë që një komunitet të ndiejë më pranë vendin e origjinës. Mund t'i japë një publiku të huaj një arsye për ta njohur më mirë një kulturë. Dhe mund të krijojë një kujtim që mbetet gjatë pas përfundimit të aktivitetit.

Nga skena e Zagrebit te ura e miqësisë

Pjesëmarrja e Big Band – OSFA në aktivitetin e organizuar nga Ambasada shqiptare në Zagreb ishte, në këtë kuptim, më shumë se një dalje artistike. Ishte një moment ku u takuan kultura, diplomacia, komuniteti shqiptar dhe energjia e një brezi të ri. Ishte një mbrëmje ku Shqipëria u përfaqësua me art dhe profesionalizëm.

Dhe brenda kësaj mbrëmjeje, takimi me Stjepan Mesić mbeti një nga momentet më njerëzore.

Sepse përtej titullit të ish-Presidentit, përtej protokollit dhe dimensionit institucional të figurës së tij, ajo që mbeti në këtë takim ishte afërsia me të rinjtë shqiptarë dhe vlerësimi për atë që ata sollën në skenë.

Është një kujtesë e bukur se marrëdhëniet mes vendeve nuk ndërtohen vetëm nga marrëveshjet dhe institucionet.

Ato ndërtohen edhe nga njerëzit. Nga respekti. Nga kultura. Nga arti. Nga brezat e rinj që takohen dhe zbulojnë se kanë më shumë gjëra që i bashkojnë sesa që i ndajnë.

Në Zagreb, në një mbrëmje kushtuar Shqipërisë, muzika e Big Band – OSFA bëri pikërisht këtë: e ktheu artin në një gjuhë miqësie dhe të rinjtë shqiptarë në një nga zërat më të bukur të përfaqësimit të vendit.

Dhe ndoshta ky është edhe mesazhi që mbetet pas kësaj vizite: Shqipëria mund të flasë për veten në shumë mënyra, por kur flet përmes talentit të të rinjve të saj, zëri i saj dëgjohet më larg.

22 NËNTORI,

DITA KUR SHQIPJA GJETI SHKRONJAT E UNITETIT

Nga Kongresi i Manastirit te përgjegjësia për ta ruajtur gjuhën shqipe në ditët tona



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Disa data i përkasin historisë, ndërsa të tjera vazhdojnë të jetojnë përmes kujtesës dhe kuptimit që mbartin në të tashmen.22 Nëntori është njëra prej tyre. Është një datë që nuk shënon vetëm përfundimin e një kongresi historik, as vetëm një vendim për mënyrën se si do të shkruhej shqipja. Ajo përfaqëson një nga momentet më të rëndësishme të përpjekjes së shqiptarëve për të bërë gjuhën e tyre një shtyllë të identitetit kombëtar, të arsimit, të kulturës dhe të bashkimit.

Më 22 nëntor 1908, në Manastir, pas ditësh të tëra diskutimesh, debatesh dhe përpjekjesh, përfaqësuesit e viseve shqiptare dhe të kolonive shqiptare jashtë atdheut i dhanë një drejtim të ri çështjes së shkrimit të gjuhës shqipe. Ishte një moment kur fjala shqipe kërkonte jo vetëm të dëgjohej, por të shkruhej me një sistem të përbashkët, të mësohej në shkolla, të botohej në libra e gazeta dhe t'u përcillej brezave.

Në pamje të parë, mund të duket si një çështje teknike: cilat shkronja do të përdoren për të shkruar shqipen? Në të vërtetë, pas kësaj pyetjeje fshihej një çështje shumë më e madhe: **a do të mund të ndërtonin shqiptarët një hapësirë të përbashkët kulturore e arsimore përmes gjuhës së tyre?**

Pikërisht këtu qëndron madhështia e Kongresit të Manastirit.

Një gjuhë, shumë alfabete dhe një nevojë historike

Përpara Kongresit të Manastirit, shqipja shkruhej me disa alfabete dhe sisteme të ndryshme. Përdoreshin alfabeti i Stambollit, alfabeti i shoqërisë "Bashkimi", ai i shoqërisë "Agimi" dhe sisteme të tjera të përdorura në rrethana të ndryshme.

Kjo shumësi ishte pasojë e një historie të ndërlikuar kulturore, politike dhe fetare. Shqiptarët jetonin në një hapësirë ku vepronin tradita të ndryshme shkrimore dhe ku çështja e alfabetit nuk ishte thjesht një zgjedhje gjuhësore. Ajo lidhej me arsimin, me botimin, me identitetin dhe me vetë të ardhmen e kulturës shqiptare.

Prandaj, Kongresi i Manastirit nuk erdhi si një ngjarje e shkëputur nga historia. Ai ishte kulmimi i një përpjekjeje të gjatë të rilindësve, të mësuesve, shkrimtarëve, klerikëve, patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë për t'i dhënë gjuhës shqipe vendin që meritonte.

Më 14 nëntor 1908 nisën punimet e Kongresit. Në Manastir u mblodhën rreth 50 delegatë nga qytete e treva të ndryshme shqiptare, si edhe përfaqësues të kolonive shqiptare në Itali, Rumani, Egjipt, Amerikë e në vende të tjera.

Ishte një kuvend i veçantë edhe për përbërjen e tij. Aty u takuan njerëz me bindje, përvoja dhe prejardhje të ndryshme, por me një shqetësim të përbashkët: **e ardhmja e gjuhës shqipe**.

32 delegatë kishin të drejtë vote, ndërsa 18 të tjerë morën pjesë në diskutime pa të drejtë vote.

Në krye të Kongresit ishte Mit'hat Frashëri, me Luigj Gurakuqin dhe Gjergj Qiriazin si nënkryetarë. Komisioni prej 11 anëtarësh që do të merrej me çështjen e alfabetit drejtohej nga At Gjergj Fishta.

Mes figurave të rëndësishme të këtij kuvendi ishte edhe Parashqevi Qiriazi, një emër që përfaqëson jo vetëm pjesëmarrjen e gruas shqiptare në një moment vendimtar të historisë kombëtare, por edhe rolin e saj të jashtëzakonshëm në arsimimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe.



Foto Kel Marubi

COMMISSIONE DELL'ALFABETO MONASTIR 1908

1. Presidente P. Giorgio Fishta O. M.
2. Mid – Frasheri
3. Luigi Gurakuqi
4. D. Qiriazi
5. D. Ndre Mjedja
6. G. Cilka
7. Teqi Buda
8. Shahin Kolonja
9. Sotir Peci
10. Bajo Topulli
11. Nyzhet Vrioni

Në Manastir nuk ishte mbledhur thjesht një grup intelektualësh. Ishte mbledhur një pjesë e rëndësishme e ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

Gjergj Fishta dhe fjala që kërkonte alfabetin e unitetit

Në historinë e Kongresit, një vend të veçantë zë Gjergj Fishta. Si kryetar i Komisionit të Alfabetit, ai ishte një nga figurat qendrore të diskutimeve. Fjalët dhe qëndrimet e tij shprehnin një shqetësim që shkonte përtej teknikës së shkrimit: nevojën për të krijuar një bazë të përbashkët për zhvillimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare.

Edhe kolonitë shqiptare jashtë vendit e ndoqën me vëmendje Kongresin. Mbështetja e tyre u shpreh edhe përmes telegrameve, ndër të cilat ishte edhe ai i Fan Nolit.

Kjo tregon diçka të rëndësishme: çështja e alfabetit nuk ishte vetëm e shqiptarëve që jetonin në Manastir apo në viset shqiptare. Ishte çështje e një kombi që, pavarësisht kufijve politikë dhe largësisë gjeografike, po kërkonte të ndërtonte një gjuhë të përbashkët kulturore.

Në këtë kuptim, Manastiri ishte edhe një pikëtakim i Shqipërisë me diasporën e saj.

Një kompromis historik
që hapi rrugën drejt alfabetit të sotëm

Diskutimet e Kongresit u përqendruan veçanërisht te tri alfabetet më të përhapura: ai i Stambollit, ai i shoqërisë "Bashkimi" dhe ai i shoqërisë "Agimi".

Zgjidhja nuk ishte e menjëhershme dhe as e thjeshtë.

Në përfundim u vendos që për një periudhë të përdoroheshin paralelisht alfabeti i Stambollit dhe një alfabet tërësisht latin, i afërt me alfabetin e shoqërisë "Bashkimi". Ky ishte një kompromis historik. Por, mbi të gjitha, ishte një hap i madh drejt konsolidimit të alfabetit latin të shqipes.

Në vendimin përfundimtar thuhej se të dy alfabetet do të mësoheshin e do të përdoreshin bashkërisht dhe se mësimi i tyre në shkollë do të ishte i detyrueshëm.

Kjo zgjidhje e përkohshme tregon edhe një tjetër veçori të Kongresit: maturinë politike dhe kulturore të atyre që morën pjesë në të.

Ata nuk kërkuan një fitore personale. Kërkuan një rrugë që mund të pranohej nga një shumicë sa më e gjerë.

Dhe pikërisht kjo është një nga mësimet më të mëdha që



Më 22 nëntor 1908, në Manastir, pas ditësh të tëra diskutimesh, debatesh dhe përpjekjesh, përfaqësuesit e viseve shqiptare dhe të kolonive shqiptare jashtë atdheut i dhanë një drejtim të ri çështjes së shkrimit të gjuhës shqipe. Ishte një moment kur fjala shqipe kërkonte jo vetëm të dëgjohej, por të shkruhej me një sistem të përbashkët, të mësohej në shkolla, të botohej në libra e gazeta dhe t'u përcillej brezave.

Manastiri i jep edhe kohës sonë: kur përballë nesh është një interes më i madh se individi, kompromisi nuk është dobësi. Është përgjegjësi.

Alfabeti nuk ishte fundi i betejës

Kongresi i Manastirit nuk e mbylli menjëherë çështjen e alfabetit. Përkundrazi, kundërshtitë politike dhe kulturore vazhduan. Më 23 korrik 1909 u zhvillua Kongresi i Dibrës, ku u shfaqën edhe qëndrime që mbështesnin përdorimin e alfabetit arab për shkrimin e shqipes. Ndërkohë, u mendua edhe për një kongres të dytë. Ai u mbajt më 2 dhe 3 prill 1910, përsëri në Manastir, nën kryesimin e Bedri Pejanit. Pra, rruga drejt alfabetit të sotëm nuk ishte një rrugë e shtruar dhe e qetë. Ajo kaloi përmes debatesh, kundërshtish, kompromisesh dhe përpjekjesh.

Por historia e provoi se vendimi i marrë në Manastir ishte një pikë kthese.

Alfabeti me bazë latine u bë themeli i shkrimit të shqipes dhe, me kalimin e kohës, u konsolidua alfabeti që përdorim sot.

Kështu, 22 Nëntori nuk është thjesht përkujtim i një mbledhjeje të vitit 1908. Është përkujtim i një procesi që ndryshoi fatin e kulturës shqiptare.

Çfarë do të thotë 22 Nëntori për shqiptarët e sotëm?

Kjo është pyetja që duhet t'ia bëjmë vetes sa herë përkujtojmë Ditën e Alfabetit.

Sepse është e lehtë të nderojmë një datë. Është më e vështirë të kuptojmë përgjegjësinë që ajo datë na lë.

Sot kemi alfabetin e njësuar. Kemi shkollat, universitetet, botimet, librat, gazetat, mediat dhe teknologjinë që e bëjnë komunikimin më të shpejtë se kurrë. Por pikërisht në këtë kohë, sfida për gjuhën shqipe ka marrë forma të reja. Në epokën e rrjeteve sociale, komunikimit të shpejtë dhe teknologjisë, shqipja përballet me një përdorim gjithnjë e më të pakujdesshëm. Shpesh fjalët shkurtohen, drejtshkrimi neglizhohet, përdoren forma të huaja pa nevojë dhe gjuha publike varfërohet. Nuk është problem teknologjia. Teknologjia është një mjet.

Problemi lind kur shpejtësia e komunikimit fillon të zëvendësojë saktësinë, kur fjala e shkruar humbet kujdesin dhe kur gjuha trajtohet si diçka që mund të përdoret pa përgjegjësi.

Ata që u mblodhën në Manastir më shumë se një shekull më parë luftuan që shqipja të kishte alfabetin e saj të përbashkët.

Ne sot duhet të luftojmë që shqipja të ketë përdorimin, dinjitetin dhe kujdesin që meriton.

Kjo është mënyra më e mirë për t'i nderuar.

Gjuha është kujtesë, identitet dhe e ardhme

Një komb nuk ruhet vetëm përmes monumenteve. Ruhet edhe përmes gjuhës.

Në gjuhë ruhen kujtimet e një populli, mënyra e tij e të menduarit, këngët, legjendat, historia, letërsia, urtësia popullore dhe përvoja e brezave.

Kur një fëmijë mëson të shkruajë shqip, ai nuk mëson vetëm të bashkojë shkronja. Ai hyn në një trashëgimi që është ndërtuar me shumë mund, sakrificë dhe përkushtim.

Prandaj, ruajtja e gjuhës nuk është detyrë vetëm e gjuhëtarëve.

Është detyrë e familjes.

Është detyrë e shkollës.

Është detyrë e institucioneve.

Është detyrë e medias.

Është detyrë e çdo qytetari që shkruan dhe flet shqip.

Në veçanti, kjo përgjegjësi bëhet edhe më e madhe në një kohë kur shqiptarët jetojnë në shumë vende të botës. Për diasporën, gjuha është një nga lidhjet më të forta me vendin e origjinës.

Një fëmijë shqiptar që jeton larg Shqipërisë, Kosovës apo viseve të tjera shqiptare mund të mos ketë mundësi të jetojë çdo ditë në mjedisin shqiptar. Por përmes gjuhës ai mund të ruajë një lidhje të drejtpërdrejtë me kulturën, familjen dhe trashëgiminë e tij.

Kjo e bën gjuhën shqipe edhe më të rëndësishme në ditët tona.

Nga Manastiri te ekrani i telefonit

Në vitin 1908, sfida ishte të gjendej një alfabet që të mund të bashkonte shqiptarët në shkrim. Sot sfida është tjetër. Sot kemi një alfabet të përbashkët, por duhet të kujdesemi për mënyrën se si e përdorim. Atëherë fjala shqipe luftonte për të hyrë në shkollë. Sot ajo duhet të ruajë vendin e saj në shkollë, në universitet, në institucion, në media dhe në hapësirën digjitale.

Atëherë duhej të botohej një libër shqip. Sot kemi mijëra libra, por duhet të sigurohemi që brezat e rinj t'i lexojnë. Atëherë shqiptarët komunikonin përmes telegrameve nga larg. Sot një mesazh mund të mbërrijë në çdo cep të botës për disa sekonda. Por, pavarësisht ndryshimit të kohës, një gjë mbetet e njëjtë: gjuha është ura që lidh shqiptarët me njëri-tjetrin. Dhe çdo urë kërkon mirëmbajtje.

Një mësim që vjen nga Manastiri

Kongresi i Manastirit na mëson se kombet nuk ndërtohen vetëm në fushat e betejave. Ato ndërtohen edhe në shkolla. Në libra. Në gjuhë. Në kulturë. Në vendime që mund të duken të vogla në momentin kur merren, por që ndryshojnë të ardhmen e brezave. Ata që u mblodhën në Manastir nuk e dinin se si do të dukej bota më shumë se një shekull më vonë. Nuk mund ta imagjinonin telefonin, internetin, rrjetet sociale apo komunikimin digjital.

Por ata kuptuan diçka që mbetet e vërtetë edhe sot, pa gjuhën, identiteti mbetet i pambrojtur; pa arsimin, gjuha mbetet e rrezikuar; pa kulturën, kombi humbet kujtesën e vet.

Prandaj, 22 Nëntori nuk duhet të jetë vetëm një ditë ceremonish, aktivitetesh dhe fjalësh përkujtimore. Duhet të jetë një ditë reflektimi. Të pyesim veten sa mirë po e përdorim gjuhën që na lanë trashëgim rilindësit.

Sa po lexojmë. Sa po shkruajmë. Sa po ua mësojmë fëmijëve. Sa po e mbrojmë nga shpërfillja. Sa po e përdorim me përgjegjësi në institucionet dhe mediat tona.

22 Nëntori, një amanet që nuk mbaron

Kongresi i Manastirit ishte një kuvend i alfabetit, por në thelb ishte një kuvend i së ardhmes. Ata burra dhe gra që u mblodhën në Manastir nuk po zgjidhnin vetëm mënyrën e shkrimit të fjalëve. Ata po përpiqeshin t'u jepnin brezave që do të vinin një mjet për të mësuar, për të komunikuar, për të krijuar dhe për të ruajtur identitetin.

Sot ne e kemi atë trashëgimi në duart tona. E kemi alfabetin. E kemi gjuhën. E kemi letërsinë. E kemi historinë. E kemi kujtesën.

Por trashëgimia nuk ruhet vetëm duke e përmendur. Ruhet duke e përdorur. Ruhet duke e mësuar. Ruhet duke e shkruar drejt. Ruhet duke e pasuruar. Ruhet duke ua përcjellë fëmijëve. Dhe mbi të gjitha, ruhet duke kuptuar se gjuha shqipe nuk është vetëm një mjet komunikimi. Ajo është një nga format më të fuqishme të kujtesës sonë kombëtare.

Më shumë se një shekull pas Manastirit, ne nuk kemi më për detyrë të zgjedhim alfabetin. Ata që erdhën para nesh e bënë atë betejë.

Detyra jonë është tjetër: **të mos e humbasim vlerën e asaj që ata fituan.**

22 Nëntori na kujton se një komb mund të ndahet nga kufijtë, nga largësia, nga historia dhe nga rrethanat, por mund të bashkohet sërish përmes gjuhës.

Në Manastir u mblodhën shkronjat. Por, në të vërtetë, aty u mblodh një komb.

Dhe sot, sa herë shkruajmë shqip, sa herë një fëmijë lexon një libër shqip, sa herë një mësues ia mëson një nxënësi një fjalë të re, sa herë një shkrimtar krijon një vepër dhe sa herë një shqiptar, kudo që ndodhet, i drejtohet tjetrit në gjuhën e përbashkët, Manastiri vazhdon të jetë i pranishëm mes nesh.

Sepse alfabeti që u diskutua në atë nëntor të vitit 1908 nuk është thjesht një sistem shkronjash.

Është një dëshmi se shqiptarët, kur vendosin përballë vetes një ideal më të madh se ndarjet e tyre, dinë të gjejnë gjuhën e përbashkët.

Dhe kjo është ndoshta porosia më e madhe e 22 Nëntorit për ditët tona: një gjuhë e përbashkët kërkon jo vetëm shkronja të përbashkëta, por edhe përgjegjësi të përbashkët për ta ruajtur.

QEMAL STAFA:

Një jetë e ndërprerë në rini, një trashëgimi që kapërceu kohën

Përtej figurës historike, portreti i një intelektuali të ri, shkrimtari dhe krijuesi



Ka figura të historisë që njihen kryesisht për aktin e tyre të fundit, për sakrificën që i bëri pjesë të kujtesës kombëtare. Por, për t'i kuptuar plotësisht, duhet të kthehemi te jeta e tyre, te formimi, mendimi, ëndrrat dhe krijimtaria që lanë pas. Qemal Stafa është një prej tyre. I njohur në historinë shqiptare si një nga figurat e rëndësishme të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, ai ishte gjithashtu një i ri me formim intelektual, me prirje letrare dhe me një ndjeshmëri të veçantë artistike. Jeta e tij u ndërpre në moshën 21-vjeçare, por ajo që la pas dëshmon se përpara se të bëhej një emër i historisë, kishte qenë një personalitet në formim, me një botë të pasur shpirtërore dhe krijuese.

Nga Elbasani në Shkodër e Tiranë, formimi i një personaliteti

Qemal Stafa lindi në vitin 1921, në Elbasan, në një familje me tradita patriotike. Fëmijëria dhe vitet e para të shkollimit ndikuan në formimin e tij, duke i dhënë mundësinë të njihej me kulturën, librin dhe mendimin e kohës. Mësimet e para i kreu në Kolegjin Saverian të Etërve Jezuitë në Shkodër, ndërsa më pas vazhdoi në Gjimnazin e Shkodrës. Në vitin 1936, familja u vendos në Tiranë dhe Qemali vijoi studimet në Gjimnazin e kryeqytetit.

Ishte një nxënës me interes të veçantë për dijen dhe letërsinë. Qysh në bankat e shkollës nisi të shfaqte aftësi në të shkruar, duke provuar të shprehte përmes hartimeve dhe skicave letrare mendimet, vëzhgimet dhe ndjesitë e tij. Në vitin 1938 përfundoi gjimnazin dhe në dhjetor të po atij viti u regjistrua në Fakultetin e Drejtësisë në Firence. Studimet nuk i vijoi gjatë. Në janar të vitit 1939 u kthye në Shqipëri, ku u arrestua nga autoritetet e kohës.

Më 4 shkurt 1939 u zhvillua gjyqi ndaj tij. Në sallën e gjyqit, i riu Qemal Stafa nuk u kufizua në rolin e të akuzuarit, por e shndërroi mbrojtjen e vet në një qëndrim të hapur kundërshtues ndaj akuzuesve. Në prill të atij viti arriti të arratisej nga burgu.

Më 8 nëntor 1941 mori pjesë në mbledhjen e themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare, si përfaqësues i grupit komunist të Shkodrës, dhe u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror të përkohshëm. Më 23 nëntor 1941 u zgjodh sekretar politik i Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste Shqiptare. Në këtë detyrë zhvilloi një veprimtari të gjerë organizative, duke kontribuar në krijimin e organizatave të rinisë në Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë, Delvinë e Fier.

Por, krahas veprimtarisë politike, një tjetër dimension i personalitetit të tij meriton të ndriçohet: ai i krijuesit.

Qemal Stafa, i riu që kërkonte të shprehej përmes letërsisë

Qemal Stafa nisi të shkruante që në moshë të hershme. Letërsia për të nuk ishte thjesht një ushtrim shkollor, por një mënyrë për të shprehur botën e brendshme, për të vëzhguar realitetin dhe për të komunikuar me kohën ku jetonte. Hartimet e para, të shkruara në bankat e shkollës, ishin fillimi i një veprimtarie krijuese që do të merrte formë në prozën e shkurtër, në skica dhe portrete letrare.

Krijimet e tij u botuan në disa prej periodikëve të kohës, si "Vatra e rinisë", "Bota e re" dhe "Shtypi". Ai përdori edhe pseudonimin **Brutus**, si dhe siglën **B-us**. Këto botime dëshmojnë se Qemali nuk ishte vetëm një i ri i përfshirë në zhvillimet politike të kohës, por edhe një autor që kërkonte hapësirën e vet në jetën kulturore e letrare.

Në krijimtarinë e tij spikat revolta, qëndresa dhe kundërshtimi ndaj nënshtrimit. Personazhet dhe figurat që ndërtonte nuk paraqiten si njerëz të dorëzuar përballë vështirësive, por si karaktere që përpiqen të ruajnë dinjitetin dhe të përballen me realitetin. Kjo prirje e bën krijimtarinë e tij interesante edhe përtej moshës në të cilën u shkrua.

Ndër shkrimet që kanë mbërritur deri te lexuesi janë "Rreze frëngjijash", "Qortimet e vjeshtës", "Nënshtypje kaltërsie", "Kanga e shtëpisë përdecke", "Shkronjat shpëtimtare vjeshtukët", "Skanje" dhe "Portreti i Skënderbeut".

Secili prej këtyre shkrimeve përfaqëson një dëshmi të një talenti që po formohej dhe të një të riu që e kishte zbuluar herët fuqinë e fjalës.

Skicat letrare, dëshmi e një bote të ndjeshme

"Qortimet e vjeshtës" është një nga krijimet që na çon drejtpërdrejt te Qemali nxënës. Skica u zhvillua fillimisht si temë hartimi, kur ai ndiqte klasën e gjashtë në Gjimnazin Shtetëror të Shkodrës, dhe u botua në vitin 1937 në revistën "Bota e re". Është domethënëse që një nxënës i asaj moshe të arrinte të ndërtonte një tekst me karakter letrar, duke e kapërcyer kufirin e zakonshëm të hartimit shkollor.

Edhe **"Nënshtypje kaltërsie"**, e botuar më 5 shtator 1937, në gazetën "Shtypi", dëshmon për prirjen e tij drejt përshkrimit dhe shprehjes artistike. Ndërsa "Kanga e shtëpisë përdecke", e botuar po në gazetën "Shtypi" me siglën B-us, është një tjetër gjurmë e hershme e veprimtarisë së tij krijuese.

Një episod domethënës lidhet me skicën "Rreze frëngjijash". Ajo u botua në vitin 1939, në gazetën "Fashizmi", pa lejen e autorit. Sapo mori dijeni për botimin, Qemal Stafa reagoi përmes një letre drejtuar drejtorit të gazetës, duke bërë të ditur publikisht se shkrimi ishte botuar pa miratimin e tij. Ky episod, përtej rrethanave të botimit, tregon rëndësinë që ai i kushtonte autorësisë dhe qëndrimit të vet ndaj përdorimit të krijimtarisë së tij.

Në këto tekste shfaqet një i ri që vëzhgon, mendon, përshkruan dhe kërkon të kuptojë botën përreth. Është një zë letrar që nuk duhet lexuar vetëm si pjesë e biografisë së tij, por edhe si një dëshmi e zhvillimit të letërsisë dhe kulturës shqiptare të viteve '30.

"Portreti i Skënderbeut", vështrimi mbi heroin kombëtar

Një vend të veçantë në trashëgiminë e tij zë shkrimi "Portreti i Skënderbeut", i cili përbën të vetmin artikull studimor të njohur që ka mbetur nga Qemal Stafa. Në të, autori ndalet te figura e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, duke e karakterizuar si një udhëheqës të vërtetë të popullit, të dalë nga gjiri i tij.

Është domethënëse që një autor kaq i ri të zgjedhë të trajtojë figurën e Heroit Kombëtar. Ky shkrim tregon interesin e tij për historinë, për figurat që kanë lënë gjurmë në identitetin shqiptar dhe për marrëdhënien ndërmjet udhëheqësit dhe popullit.

Skënderbeu, në vështrimin e Qemalit, nuk është thjesht një figurë historike e largët, por një personalitet që mishëron lidhjen me vendin dhe me njerëzit e tij. Përmes këtij shkrimi, krijimtaria e tij fiton edhe një dimension tjetër: atë të reflektimit historik dhe të mendimit mbi figurat e mëdha të kombit.

Një shpirt krijues përtej fjalës së shkruar

Për të plotësuar portretin e Qemal Stafës, vëmendje meriton edhe prirja e tij artistike dhe interesimi për artet pamore. Dimensioni i tij si piktor duhet parë në lidhje me atë ndjeshmëri krijuese që shfaqet edhe në shkrimet e tij: aftësinë për të vëzhguar, për të kapur detaje, për të ndërtuar portrete dhe për t'i dhënë formë një mendimi përmes figurës artistike.

Nëse letërsia ishte një nga mënyrat me të cilat ai shprehte botën e vet, arti pamor përbën një tjetër fushë të interesit të tij krijues. Për këtë dimension, dokumentimi i veprave dhe i dëshmive konkrete do të ishte një kontribut i rëndësishëm për të plotësuar më tej portretin e tij intelektual.

Qemal Stafa nuk duhet parë vetëm përmes rolit që luajti në ngjarjet politike të kohës. Ai ishte edhe një i ri që lexonte, shkruante, krijonte dhe kërkonte të kuptonte shoqërinë. Në këtë kuptim, trashëgimia e tij letrare është një pjesë e rëndësishme e kujtesës që na ndihmon të njohim njeriun përtej figurës historike.

Një jetë e shkurtër, një kujtesë e gjatë

Më 5 maj 1942, Qemal Stafa u rrethua nga forcat kundërshtare në një lagje të Tiranës dhe u vra. Ishte vetëm 21 vjeç. Vdekja e tij ndërpreu një jetë të re, një veprimtari politike intensive dhe një rrugëtim krijues që kishte ende shumë për të dhënë.

Por koha nuk e fshiu atë që kishte lënë pas. Emri i tij mbeti pjesë e historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndërsa shkrimet e tij vijojnë të dëshmojnë për një talent të hershëm dhe për një personalitet me interesa përtej angazhimit politik.

Ta njohësh Qemal Stafën do të thotë të njohësh jo vetëm historinë e një të riu që u bë pjesë e ngjarjeve të mëdha të kohës, por edhe botën e tij intelektuale e artistike. Do të thotë të lexosh skicat, të zbulosh ndjeshmërinë, të ndjekësh mendimin dhe të kuptosh se pas emrit të njohur qëndronte një njeri me shumë dimensione.

Sepse historia ruan aktin e tij, ndërsa krijimtaria na afron me mendjen, ndjeshmërinë dhe shpirtin e tij.



QEMAL STAFA
HERO I POPULLIT



Qemal Stafa duke luftuar.
Grafikë e kohës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

SHEGERTI I VOGËL

Asht mëngjes.

Para derës së nji shtëpie përdhecke, i ulun mbi nji gur, rri mendueshëm nji çun i vogël.

Trupi i tij i mpitë të difton çiltas se asht nja dymbëdhetë vjeç. Ka të veshme disa rrobe të vjetra, të arnueme aty-këtu, por me kujdes e të pastra.

Ia mbulojnë kambët nji palë opinga të kuqe prej gome. Fytyra e tij e shqetësueme shfaq se i ka ndodhë nji fatkeqësi asaj zemre ende të njomë.

Ka mbështetë kryet në dy grushtat e tij të vegjël dhe bërrylat në kupat e gjujve dhe rrin nj'ashtu i zhytun në mendime të thella.

Ças në ças ngre kryet e, si i zgjuem prej ndonji gjumi të randë, i drejton dy sytë e tij të zez kah dera e shtëpisë përdhecke...

Në nji shej kohe, ai ngrihet e, si të ketë vendosë ndonji send, fillon me ecë.

Rrugës shikon andej e këndej ndër dyqane, mendon e prapë vijon rrugën...

Ka kalue nji copë rrugë, kur ndalet përpara nji dyqani, hedh nji shikim brenda dhe hyn.

Djaloshi përshkohet nëpër dy rreshta thasësh, arkash e teneqesh dhe, tue shikue gjithë ata kosha me pemë, ato mure të nxime të thuesh prej vjetërsisë dhe pluhunit, ato sergjia gati të shkatërruëeme, i vete syni ke nji burrë i gjatë me disa rrobe të ndyta, me do mustaqe të gjata, me nji fytyrë zeshkane e në krye nji qeleshe të zezë jo të vjetër, po të ndytë, me nji gjoks të gjanë, që e mbulon nji këmishë e murrme; prej brezit i varet nji mafrë e madhe e kuq-mbyllë e plot njolla, që mbështetet plotësisht përmbi pantallonat e rrudhuna. Asht ky Alush aga: një burrë nja pesëdhetë vjeç e i zoti i dyqanit. Çunit të vogël tue u gjetë para këtij njeriu, zemra i ndrydhet e nji përqethje e mprehtë ia përshkon shtatin, pse shokët e tij i kanë thanë që Alush aga asht njeri i egër dhe nuk i merr me të mirë djeltë e vegjël. Por çuni i vogël tue i lanë në njanën anë këto mendime, i uron Alush agës mirëmëngjesin.

Ai, pa iu përgjigjë urimit, me njifarë përbuzje e pyet se ç'don.

- Due... kishe me dashtë...

- Çka? – i thotë Alush aga tue i përkulë shtatin paksa përmbi çunin.

- Kishe me dashtë me u vendue shegert me zotninë tande, - përgjigjet çuni i vogël me nderim.

Alush aga drejtohet, rrudh vetullat e tij të trasha e mendon...

Mbas nji grime, tue e shikue ç'prej majës së kresë deri në fund të kambëve e tue tundë kryet, ia nisi me folë:

- A kishe me i ba punët e dugajës ashtu si të due unë?

- Si urdhnon, deri ku të mundem kam me ba çmos që me i krye mirë.

- Mirë pra, po e bajmë provën sot. kam me të dhanë për të parën ditë dy lekë, mbasandaj ta shofim. Si të duket?

Çuni i vogël pranon e, mbasi hjek xhaketën, fillon me punue...



Qemal Stafa, vizatim (ruhet në familje, Tiranë).

Së pari, merr fshesën dhe fshin dyqanin, mbasandaj me nji pecë ia nis me shpluhunue sergjitë e sendet e tjera, dhe kështu, njanën mbas tjetrës, i kryen punët e dyqanit ma së miri.

Alush aga, t'i porositmen nji pune, menjiherë i thotë me ba këtë tjetrën. Për gabimin ma të vogël ai e qorton me fjalët ma të ashpra, me shamjet ma të pabajtshme.

Po shegerti i vogël i kryen urdhnat e mban të shamet e mjeshtrit të vet pa ba vër me gojë.

Alush aga vetë çuditet për këtë djalë që punon me kaq zell dhe i mban fjalët e tij ç'mos kurrë nji tjetër.

Ai shef në atë qenie të vogël diçka të jashtëzakonshme, që e cilëson dhe e ban me mendue thellë për të.

* * *

Kështu kaloi dita, një ditë në të cilën dyqani i Alush agës mori nji pamje tjetër; gjithçka ishte në rregull, e pastër.

Ndërkaq dielli dalkadalë po prendonte për me i lëshue vendin natës, që porsi ndonji zojë e randë po vinte prej lindjes...

Qielli kishte marrë nji ngjyrë të purpurt dhe u dukte porsi nji kupë e artë...

Në qytet u shifte nji lëvizje e madhe: Lëvizja e zakonshme që qyteti ka në mbramje.

Nj'atje vonë, kur Alush agës iu mbush mendja se nuk kishte ç'me i urtdhnue ma çunit të vogël, e thirri e, tue e shikue në sy, i dha dy lekët e premtuem e i tha të shkonte.

Çuni, si përshëndeti me nderim mjeshtrin e vet, u vesh, duel prej dyqanit e me hapa të shpejtë u drejtue kah rruga ku u gjindte shtëpia përdhecke.

Ecte shpejt e pa i vue vesh kujt. Për te kot u lëkundshin shregllat, kot këndojshin vashat me zanin e tyne të ambël. Ai kishte veç nji mendim: shtëpinë përdhecke. Ecte e ecte, u dukte i vetëm, por mbrapa e kishte Alush agën, që i çuditun prej prumit të tij, i ishte vue mbrapa dhe e ndiqte hap pas hapi.

Mbërriti, kapi dorzën e derës, e shtyni lehtë dhe në majë të gishtave iu afrua nji shtrati të unjët, shikoi me vëmendje dhe tyue i afrue buzët e veta të njoma, i mbështeti përmbi fytyrën e thatë e të vdekshme që u gjendte aty.

Mandej nxori dy lekët prej xhepit, i vuri në dorën e ligësht të grues së smuet e i tha:

- Qe nanë, qe fryti i mundit të parë që unë derdha për ty...

Kolonel (R) Hysni Gjergji: Përvoja e uniformës në kërkim të përgjigjeve strategjike

Kolonel (R) **Hysni Gjergji** është ndër ata ushtarakë që, edhe pas përfundimit të karrierës në uniformë, vijojnë ta shohin zhvillimin e çështjeve të sigurisë dhe të mbrojtjes si një fushë të pandarë nga përvoja e tyre profesionale. Për të, njohja e historisë ushtarake, e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe e zhvillimeve strategjike nuk është vetëm një pasion intelektual, por një mënyrë për të kuptuar më mirë sfidat me të cilat përballet bota e sotme.

Me formimin dhe përvojën e një oficeri të karrierës, kolonel Gjergji i qaset zhvillimeve të sigurisë përmes një këndvështrimi ku përvoja praktike e profesionit ushtarak ndërthuret me analizën dhe reflektimin. Pikërisht kjo e bën shkrimin e tij një zë të veçantë në hapësirën e analizës ushtarake: ai nuk ndalet vetëm te ajo që ndodh, por kërkon të lexojë shkaqet, pasojat dhe drejtimin që mund të marrë e ardhmja.

Në këtë qasje, vëmendja e kolonel Gjergjit shkon përtej kufijve të një zhvillimi të veçantë ushtarak. Ai e sheh sigurinë si një sistem të ndërlidhur, ku fuqia, diplomacia, institucionet ndërkombëtare dhe interesat strategjike të shteteve përcaktojnë ekuilibrat e botës.

Në analizën që sjell për lexuesin e gazetës **"Ushtria"**, kolonel (R) Hysni Gjergji ndalet pikërisht te një prej çështjeve më të mëdha të kohës, e ardhmja e mbrojtjes kolektive dhe aftësia e arkitekturës së sotme ndërkombëtare për t'iu përgjigjur ndryshimeve të mëdha të fuqisë botërore. Një reflektim që buron nga përvoja e një ushtaraku, por që shkon përtej saj, duke prekur një pyetje që mbetet e hapur për të gjithë: **a mund të garantohet siguria kolektive në një botë ku vetë ekuilibrat e fuqisë po ndryshojnë?**

A do të mbijetojë mbrojtja kolektive, pa ndryshuar arkitektura e fuqisë botërore?



KOLONEL (R) HYSNI GJERGJI
Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes

Anëtarësimi në vitin 1955 dhe pjesëmarrja si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit në vitet 2022–2023 dëshmojnë peshën që diplomacia shumëpalëshe mund t'i japë një shteti të vogël. Për Forcat tona të Armatosura dhe institucionet e sigurisë, përvoja e OKB-së kujton se mandatet, gatishmëria, mbrojtja e civilëve, koordinimi me aleancat dhe llogaridhënia duhet të ecin së bashku.

Tetëdhjetë e një vjet pas hyrjes në fuqi të Kartës së Kombeve të Bashkuara, më 24 tetor 1945, debati mbi të ardhmen e OKB-së nuk kufizohet te mosha e një institucioni. Organizatat nuk vjetrohen vetëm sepse kalojnë dekadat, por ato vjetrohen kur realiteti që duhet të rregullojnë ndryshon më shpejt sesa aftësia e tyre për t'u përshtatur. Prandaj çështja sot nuk është nëse Kombet e Bashkuara e kanë humbur arsyen e ekzistencës, por nëse rendi politik që e krijoi vazhdon të jetë i angazhuar të mbështesë premtimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me të drejtë dhe diplomaci dhe jo vetëm me forcë? Në kushtet dhe rrethanat e reja pyetja tjetër është: A do të mbijetojë mbrojtja kolektive e garantuar nga OKB-ja, pa ndryshuar arkitektura e fuqive botërore?

Në vitin 1945, bota dilte nga një luftë që kishte shkatërruar qytete, ekonomi dhe vetë besimin te qytetërimi. Dështimi i Lidhjes së Kombeve kishte dëshmuar se parimet pa mekanizma politikë ishin të pambrojtura. Karta e nënshkruar në San Francisko, më 26 qershor, dhe e hyrë në fuqi katër muaj më vonë formuloi ambicie historike, të pengonte një përplasje të re botërore, të ndalonte kërcënimin ose përdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të njihte barazinë sovrane të shteteve. Mirëpo, themeluesit nuk ndërtuan një qeveri të botës. Ata krijuan një sistem bashkëpunimi mes qeverive, ku detyrimi juridik do të bashkëjetonte me interesin kombëtar.

Kjo kontradiktë u vendos në themel të Këshillit të Sigurimit. Pesë fuqive të përhershme iu dha e drejta e vetos jo sepse bota ishte e barabartë, por sepse arkitektët e pasluftës besonin se pa pjesëmarrjen e fuqive kryesore çdo mekanizëm sigurie do të dështonte. Ishte një kompromis realist, por edhe një hipotekë mbi të ardhmen: organizata do të mund të vepronte vendosmërisht vetëm kur interesat e fuqive të mëdha nuk do ta bllokonin njëra-tjetrën. Këtu gjendet paradoksi që e shoqëron OKB-në edhe sot. Ajo u krijua për të kufizuar politikën e forcës, ndërsa aftësia për ta zbatuar këtë kufizim iu besua pikërisht atyre që zotëronin fuqinë më të madhe.

Lufta e Ftohtë e provoi menjëherë këtë kufi. Nga Gadishulli Korean te Lindja e Mesme, rivaliteti mes dy blloqeve e ktheu shpesh Këshillin në arenë përplasjeje diplomatike. Por bllokimi i vendimmarrjes së lartë nuk e ndali ndërtimin e një infrastrukture universale normash. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, Konventa kundër Gjenocidit po atë vit, institucionet e refugjatëve dhe mekanizmat e shëndetësisë ndërkombëtare u dhanë njerëzve e shteteve një gjuhë të re përgjegjësie. Normat nuk i ndaluan automatikisht krimet; ato krijuan kriteret për t'i identifikuar, dokumentuar dhe gjykuar. Në të njëjtin vit, 1948, vëzhguesit ushtarakë të OKB-së u vendosën në Lindjen e Mesme. Kështu nisi paqeruajtja, një instrument që Karta nuk e kishte përcaktuar hollësisht, por që nevoja e krijoi. Pas krizës së Suezit më 1956, misionet u zhvilluan nga vëzhgimi i armëpushimeve drejt pranisë shumëkombëshe në terren. Ushtarët me helmeta blu nuk ishin projektuar të fitonin luftëra në vend të shteteve; detyra e tyre ishte të ulnin rrezikun e përplasjes, të mbronin hapësirën për negociata dhe, më vonë, të mbështesnin zbatimin e marrëveshjeve politike. Kjo formulë mbetej e brishtë kur palët nuk jepnin pëlqim ose kur mungonin mjetet për të mbrojtur civilët.

Dekolonizimi i viteve 1950–1970 ndryshoi jo vetëm hartën e botës, por edhe vetë OKB-në. Shtetet e reja të Afrikës dhe Azisë sollën në Asamblenë e Përgjithshme përvoja që nuk përfaqësoheshin në tavolinën e pesë anëtarëve të përhershëm. Në vitin 1955, me pranimin e Shqipërisë më 14 dhjetor, zgjerimi i anëtarësisë shënonte edhe një fakt të rëndësishëm për vendet e vogla: sovraniteti dhe e drejta për t'u dëgjuar nuk duhet të varen nga madhësia e territorit apo fuqia ushtarake.

Megjithatë, vitet e Luftës së Ftohtë nuk ishin vetëm histori vetosh. Përmes programeve të zhvillimit, ndihmës ushqimore, vaksinimit dhe së drejtës ndërkombëtare, sistemi i OKB-së u bë i pranishëm atje ku diplomacia e fuqive ishte e padukshme. Zhdukja e lisë natyrore, e shpallur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 1980, mbetet shembull i prekshëm i bashkëpunimit që kapërceu rivalitetet. Konferenca e Stokholmit për mjedisin në vitin 1972 dhe Konventa për të Drejtën e Detit e miratuar në vitin 1982, zgjeruan idenë e sigurisë se paqja nuk garantohet vetëm duke shmangur luftën, por edhe duke përcaktuar rregulla të përbashkëta për shëndetin, burimet dhe hapësirat ku interesat përplasen.

Rënia e Murit të Berlinit krijoi një moment shprese. Por pritshmëritë ndaj organizatës u rritën shumë më shpejt sesa kapacitetet që shtetet ishin të gatshme t'i vinin në dispozicion. Një mision mund të kishte flamurin e botës dhe njëkohësisht të mos kishte autoritetin, mjetet ose mbështetjen politike për ta përmbushur detyrën.

Për Ballkanin, fundi i shekullit XX e bëri këtë debat të prekshëm. Gjykatat ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën provuan se përgjegjësia për krime të rënda mund të individualizohej edhe kur shtetet e kundërshtonin. Në Kosovë, pas konfliktit të vitit 1999, Rezoluta 1244 vendosi një kuadër të veçantë të pranisë ndërkombëtare dhe administrimit të përkohshëm. Përvoja tregoi njëkohësisht potencialin e administrimit ndërkombëtar për stabilizim dhe kufirin e tij në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve politike afatgjata. OKB-ja mund të krijojë kushte për një proces, por nuk mund t'ia zëvendësojë aktorëve politikë marrëveshjen që ata nuk e arrijnë.

Pas vitit 2000, organizata u përball me kërcënime që nuk përshtateshin me kufijtë klasikë të konfliktit ndërshtetëror: terrorizmin, migrimin e detyruar, epidemitë, ndryshimin klimatik dhe pasigurinë ushqimore. Debatet për ndërhyrjen në Irak në vitin 2003 treguan se çështja e legjitimitetit të përdorimit të forcës mbetej thellësisht përçarëse. Ndërsa në vitin 2005, parimi i përgjegjësisë për të mbrojtur popullsitë nga krimet më të rënda synoi të afronte sovranitetin me përgjegjësinë. Problemi mbeti i njëjtë: kush vendos, mbi çfarë prove dhe me cilat mjete vepron bashkësia ndërkombëtare kur mbrojtja e njerëzve përplaset me interesat gjeopolitike? Agjenda 2030 dhe Marrëveshja e Parisit për klimën, të dyja të vitit 2015, e zgjeruan më tej nocionin e sigurisë. Stabiliteti kërkon ekonomi funksionale, qasje te burimet, shërbime publike dhe aftësi për t'u përshtatur me ndryshimet mjedisore. Pandemia e COVID-19 dëshmoi më pas se ndërvarësia nuk prodhon automatikisht solidaritet: krizat globale mund të kenë institucione të përbashkëta, ndërsa qeveritë të mbeten konkurrente për vaksina, teknologji dhe furnizime. OKB-ja u shfaq si platformë koordinimi, por jo si autoritet që mund t'i detyronte shtetet t'i jepnin përparësi interesit kolektiv.

Pas pushtimit të gjerë të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022, u rikthye në mënyrë dramatike problemi i parimit të paprekshmërisë territoriale. Kur një anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit është vetë palë në konflikt, vetoja mund të pengojë vendimet detyruese të organit që ka përgjegjësinë parësore për paqen. Këtu lind pyetja nëse kriza është e OKB-së apo e rendit që ajo përfaqëson? Megjithatë, pjesa më e madhe e bllokimeve të sigurisë buron nga mospajtimi i shteteve që vendosin në emër të tij. I kërkohet OKB-së të prodhojë paqe, ndërkohë që fuqia ushtarake, financimi, sanksionet dhe vullneti për t'i zbatuar vendimet mbeten kryesisht në duart e qeverive. Të fajësosh vetëm organizatën për çdo dështim do të thotë të ngatërrosh instrumentin me arkitekturën politike që ia përcakton kufijtë. Edhe përfaqësimi është kthyer në provë legjitimiteti. Këshilli i Sigurimit ka pesë anëtarë të përhershëm, ndërsa Afrika nuk ka asnjë vend të përhershëm, pavarësisht peshës së saj demografike dhe numrit të konflikteve ku organizata angazhohet. India, Brazili, Gjermania dhe Japonia kërkojnë një përfaqësim më të përshtatshëm të botës së sotme. Por reforma e thellë has një pengesë institucionale, sepse sipas nenit 108 të Kartës, ndryshimet duhet të ratifikohen edhe nga të pesë anëtarët e përhershëm. Megjithatë, sistemi nuk ka qëndruar plotësisht në vend. Në vitin 2022, Asambleja e Përgjithshme vendosi që përdorimi i vetos në Këshill të pasohej nga një debat në Asamble, si një formë transparence dhe përgjegjësie politike. Në shtator 2024 u miratua Pakti për të Ardhmen, me marrëveshjen globale për bashkëpunimin digjital dhe deklaratën për brezat e ardhshëm. Nisma UN80, e nisur në vitin 2025, i dha reformës së OKB-së një dimension më praktik. Në maj 2026, Sekretari i Përgjithshëm António Guterres paralajmëroi se ruajtja e gjendjes ekzistuese ishte e paqëndrueshme. Programi synon të ulë dyfishimet, të përmirësojë zbatimin e mandateve dhe të riorganizojë shërbimet e strukturat. Por duhet dalluar qartë reforma administrative nga reforma politike. Kursimi i fondeve, shkurtimi i procedurave dhe bashkimi i funksioneve mund ta bëjnë organizatën më efikase, por nuk mund t'i japin asaj konsensusin e munguar të fuqive të mëdha. Pa reformë të përfaqësimit dhe pa përgjegjshmëri në vendimmarrje, një OKB më e kursyer mund të mbetet po aq e paralizuar në çastet vendimtare. Në hapjen e debatit të përgjithshëm të sesionit të 81-të të Asamblesë, më 22 shtator 2026, Guterres paralajmëroi se ndarjet botërore po thellohen dhe e vendosi njerëzimin përballë provave të luftës e paqes, pabarazisë, klimës dhe inteligjencës artificiale. Kryetari i Asamblesë, Khalilur Rahman, kërkoi rikthimin e besimit dhe një Këshill Sigurimi më përfaqësues.

Sfida e radhës për OKB-në mund të mos vijë vetëm nga tanket dhe kufijtë. Inteligjenca artificiale, sulmet kibernetike, manipulimi i informacionit, zinxhirët e furnizimit dhe konkurrenca për teknologjitë kritike e vështirësojnë identifikimin e përgjegjësisë dhe të agresionit. Një institucion i ndërtuar për luftërat mes shteteve duhet të ndihmojë në krijimin e normave edhe për hapësirën digjitale, pa e kthyer çdo mosmarrëveshje teknologjike në krizë sigurie. Rreziku nuk është vetëm që OKB-ja të mos reagojë në kohë, por edhe që shtetet të fillojnë ta zëvendësojnë rregullin e përbashkët me marrëveshje të përkohshme sipas parimit të të fortit dhe interesit të çastit.

Në bilancin e 81 viteve, OKB-ja nuk mund të gjykohet vetëm nga luftërat që nuk arriti t'i ndalonte. Pa OKB-në, bota do të kishte më pak standarde të përbashkëta për të drejtat, refugjatët, shëndetin, ndihmën humanitare dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, por as nuk mund të shpallet e suksesshme vetëm nga numri i rezolutave dhe agjencive që ka krijuar. Sfida e saj përfundimtare është aftësia për të kthyer legjitimitetin në rezultate. Rendi i vitit 1945 po ndryshon dhe institucioni e pasqyron këtë tension. Prandaj nuk po vjetrohet ideja e Kombeve të Bashkuara. Po vjetrohet pretendimi se marrëveshja e fuqisë së pasluftës mund të qeverisë pa ndryshime një botë shumëpolare, të ndërlidhur dhe teknologjikisht të transformuar.

Për Shqipërinë, ky debat për OKB-në nuk është abstrakt. Anëtarësimi në vitin 1955 dhe pjesëmarrja si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit në vitet 2022–2023 dëshmojnë peshën që diplomacia shumëpalëshe mund t'i japë një shteti të vogël. Për Forcat tona të Armatosura dhe institucionet e sigurisë, përvoja e OKB-së kujton se mandatet, gatishmëria, mbrojtja e civilëve, koordinimi me aleancat dhe llogaridhënia duhet të ecin së bashku. NATO-ja dhe mekanizmat rajonalë nuk e zëvendësojnë universalitetin juridik të Kartës, sikurse OKB-ja nuk zëvendëson kapacitetet kombëtare për mbrojtjen në tërësi dhe industrinë e mbrojtjes në veçanti. Sot pasi OKB-ja është 81 vjeç, të gjithë pyesim: A do të mbijetojë mbrojtja kolektive e garantuar nga OKB-ja, pa ndryshuar arkitektura e fuqive botërore?

Nga plumbi i parë te snajperi: Evolucioni i armës së precizionit



MARIN MEKSI



Pak histori mbi armën luftarake të precizionit nga sportisti elitar Marin Meksi, titullar për disa vite në Kampionatin e Qitjes me armë luftarake precizioni të organizuar nga Forcat Speciale Hungareze TEK.

Që nga dita kur njeriu hodhi gurin e parë drejt një shënjestre, ai ka ëndërruar të godasë më larg dhe më saktë. Historia e armës së precizionit është, në thelb, historia e kësaj ëndrre: një rrugëtim i gjatë ku shkenca, mjeshtëria dhe durimi njerëzor janë ndërthurur për të ngushtuar hapësirën midis synimit dhe goditjes.

Por kjo histori nuk është vetëm historia e armëve. Është edhe historia e njerëzve që i mbajtën ato. Çdo shpikje e re, nga tyta me vija (vjaskuar) te optika moderne, ka kërkuar një lloj të ri qitësi: më të duruar, më të vëmendshëm ndaj mjedisit dhe më të disiplinuar. Në këtë rrëfim do të ndjekim të dyja rrugët njëkohësisht, sepse ato nuk mund të ndahen.

Fillimet: tyta me vija dhe pushkët e gjata

Armët e para të zjarrit ishin me tytë të lëmuar. Plumbi sferik dilte duke u rrotulluar rastësisht, dhe pas disa dhjetëra metrash askush nuk mund të thoshte me siguri ku do të binte. Ushtritë e kompensonin këtë me sasi: rreshta të gjatë ushtarësh që qëllonin njëkohësisht, duke shpresuar se dikush do të godiste.

Ndryshimi i madh erdhi me idenë e vijave spirale brenda tytës, e njohur në Evropë qysh në shekullin XV. Vijat i jepnin plumbit rrotullim të qëndrueshëm, ashtu si një top i hedhur me rrotullim fluturon më drejt. Rezultati ishte një saktësi e paparë, por me një çmim: mbushja e armës ishte e ngadaltë, sepse plumbi duhej shtyrë me forcë nëpër vija.

Në shekullin XVIII, gjuetarët e kufirit amerikan përsosën të ashtuquajturën pushkë e gjatë (Pennsylvania ose Kentucky rifle). Këta njerëz jetonin nga gjuetia dhe mësuan të lexonin erën, terrenin dhe distancën si pjesë të jetës së përditshme. Gjatë Luftës së Pavarësisë, disa prej tyre treguan se një qitës i vetëm, i fshehur dhe i duruar, mund të ndikonte në rrjedhën e një beteje.

Britanikët e mësuan mësimin shpejt. Në vitin 1800 ata krijuan njësi të specializuara të pajisura me pushkën "Baker", të veshura me jeshil në vend të së kuqes tradicionale, që të binin më pak në sy. Për herë të parë, qitësi i saktë nuk ishte më një përjashtim, por një rol i organizuar.

Shekulli XIX: plumbi "Minié" dhe lindja e snajperit

Në mesin e shekullit XIX, oficeri francez Claude-Étienne Minié zgjidhi problemin e mbushjes së ngadaltë. Plumbi i tij i zgjatur, me bazë të zbrazët, rrëshqiste lehtë në tytë dhe zgjerohej nga gazrat në momentin e goditjes, duke u kapur pas vijave. Papritur, çdo ushtar mund të mbante një armë me vija.

Në Angli, inxhinieri Joseph Whitworth shkoi edhe më tej. Pushka e tij, me tytë gjashtëkëndëshe, u bë e famshme për saktësinë në distanca që më parë dukeshin të pamundura. Gjatë Luftës Civile Amerikane, qitësit që e përdorën atë fituan një reputacion pothuajse legjendar. Në të njëjtën luftë, njësitë e Berdanit (reparte me qitës të përzgjedhur për saktësinë e tyre), në ushtrinë e Veriut gjatë Luftës Civile Amerikane (1861–1865), të njohura si "Sharpshooters", pranonin vetëm burra që kalonin një provë të rreptë qitjeje.

Pikërisht në këtë periudhë u përhap edhe fjala që përdorim sot. Oficerët britanikë në Indi e quanin "sniping" gjuetinë e shapkës (snipe), një zog i vogël dhe i shpejtë, aq i vështirë për t'u goditur sa vetëm gjuetarët më të mirë ia dilnin. Me kalimin e kohës, fjala "snajper" kaloi nga gjuetia në fjalorin ushtarak, si emër për qitësin që godet me saktësi nga larg.

Në fund të shekullit, baruti pa tym dhe fishekët metalikë ndryshuan sërish gjithçka. Armët qëllonin më larg, më shpejt dhe pa lënë re tymi që tradhtonin vendndodhjen e qitësit. Gjatë Luftës së Boerëve, fermerët boerë, me pushkë moderne dhe njohje të thellë të terrenit të tyre, i treguan botës se maskimi dhe durimi ishin po aq të rëndësishme sa vetë arma.

Luftërat botërore: syri i dytë i qitësit

Lufta e Parë Botërore, me llogoret e saj të ngurtësuara, e ktheu qitjen e precizionit në një luftë të heshtur e të përditshme. Gjermania hyri në luftë me një avantazh: industria e saj optike, një nga më të zhvilluarat në botë, prodhonte dylbi dhe optika që u montuan mbi pushkët ushtarake. Britanikët iu përgjigjën duke ngritur shkolla të posaçme, ku mësohej jo vetëm qitja, por edhe vëzhgimi, maskimi dhe leximi i hartave. Lindi kështu ideja e çiftit qitës–vëzhgues, që mbijeton edhe sot.

Në Luftën e Dimrit të viteve 1939–1940, Finlanda e vogël i rezistoi një fqinji shumë më të madh. Qitësit finlandezë, të mësuar me pyjet e mbuluara me dëborë dhe me të ftohtin ekstrem, u bënë simbol i asaj rezistence. Shumë prej tyre preferonin shenjëzat e hapura në vend të optikës, sepse xhami mund të ngrinte ose të reflektonte dritën. Mësimi ishte i qartë: njohja e mjedisit vlen më shumë se pajisja.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik e ngriti qitjen e precizionit në një shkallë të paparë, duke trajnuar me mijëra qitës, mes tyre edhe shumë gra. Beteja e Stalingradit u bë skena e dueleve të gjata mes qitësve, ku fitorja varej nga durimi për të pritur me orë të tëra pa lëvizur. Ndërkohë, të gjitha palët kuptuan se trajnimi sistematik, jo talenti i rastësishëm, ishte çelësi i suksesit.

Nga Lufta e Ftohtë deri sot

Pas vitit 1945, shumë ushtri e lanë pas dore qitjen e precizionit, duke e parë si mbetje të luftërave të kaluara. Konflikti në Vietnam e ndryshoi këtë qëndrim. Ushtria amerikane rizbuloi vlerën e qitësit të trajnuar dhe ngriti programe të reja, ku përdoreshin pushkë me mekanizëm rrotullues, të ndërtuara mbi modele gjuetie dhe sportive. Dallimi midis armës së gjuetarit dhe asaj të profesionistit po ngushtohej.

Në dekadat që pasuan, inxhinieria e armëve arriti nivele të reja: tyta të rënda me tolerancë shumë të ngushtë, materiale të qëndrueshme ndaj temperaturës dhe lagështisë, optika me zmadhim të ndryshueshëm dhe rrjeta matëse. Në vitet 1980 u shfaqën edhe pushkët e kalibrit të madh, të projektuara për distanca shumë të gjata.

Revolucioni më i madh i kohës sonë, është dixhital. Telemetrat me lazer matin distancën brenda një sekonde, stacionet e vogla meteorologjike matin erën dhe dendësinë e ajrit, dhe llogaritësit balistikë në telefon parashikojnë trajektoren. Ajo që dikur kërkonte vite përvojë, sot mund të ndihmohet nga një pajisje xhepi.

Në të njëjtën kohë, qitja e precizionit ka lulëzuar si sport. Garat e distancave të gjata, disiplinat olimpike dhe kompeticionet si Precision "Rifle Series" tërheqin mijëra pjesëmarrës në mbarë botën. Këtu, aftësitë e lindura në fushëbetejë jetojnë në një formë paqësore: si sfidë ndaj vetes, ndaj erës dhe ndaj distancës.

Ajo që nuk ka ndryshuar

Nëse do të vendosnim krah për krah një gjuetar të shekullit XVIII dhe një qitës sportiv të sotëm, armët e tyre do të dukeshin si nga botë të ndryshme. Megjithatë, të dy do të kuptonin njëri-tjetrin pa vështirësi, sepse themelet e artit të tyre janë po ato.

I pari është pozicioni i qëndrueshëm: trupi që mbështetet te kockat dhe te toka, jo te muskujt e lodhur. I dyti është frymëmarrja e qetë, sepse çdo shkëmbim ajri thuhet se ndikon në lëvizje nanometri të armës. I treti është shtypja e butë dhe e njëtrajtshme e këmbëzës, ku goditja vjen pothuajse si surprizë. I katërti është ndjekja: qëndrimi i palëvizur edhe pas goditjes, për të parë dhe për të mësuar.

Përtej trupit, mbetet leximi i mjedisit. Era, drita, distanca dhe terreni kanë qenë sfida të njëjta për qitësin e Whitworth-it dhe për atë me kalkulator dixhital. Teknologjia ndihmon, por syri i stërvitur dhe gjykimi i qetë mbeten të pazëvendësueshëm. Dhe mbi të gjitha qëndron disiplina: respekti për sigurinë, për ligjin dhe për përgjegjësinë që vjen me çdo armë.

Historia e armës së precizionit është një udhëtim prej pesë shekujsh, nga vijat e para të gdhendura me dorë te pajisjet dixhitale të sotme. Çdo hap përpara ka kërkuar një qitës më të mirë, jo vetëm një armë më të mirë. Kjo është ndoshta e vërteta më e thellë e këtij rrëfimi: precizioni nuk lind në tytë, por te njeriu që e mban. Durimi, vëzhgimi dhe disiplina, të njëjta që i kishin gjuetarët e parë, mbeten edhe sot thelbi i këtij arti.

TIRANA E 17 NËNTORIT

Një betejë, një fitore, një kujtesë

17 nëntori i vitit 1944 mbetet një nga datat më të rëndësishme të historisë së kryeqytetit shqiptar

Pas 19 ditësh e netësh luftimesh të ashpra e të pandërprera, Tirana u çlirua nga pushtuesit gjermanë, duke shënuar një kthesë vendimtare në mësymjen e përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Çlirimi i kryeqytetit nuk ishte vetëm përfundimi i një beteje të gjatë për Tiranën. Ai ishte kulmi i një operacioni ushtarak me rëndësi të veçantë strategjike, politike dhe simbolike. Tirana, si qendra e vendit, përfaqësonte një objektiv të rëndësishëm për të dyja palët.

Për forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre, mbajtja e saj kishte vlerë për kontrollin e territorit dhe tërheqjen e organizuar drejt veriut. Për forcat partizane, çlirimi i kryeqytetit ishte një objektiv madhor i mësymjes së përgjithshme dhe një sinjal i qartë se fundi i pushtimit ishte afër. Një betejë që nisi shumë më herët se 17 nëntori, Operacioni për çlirimin e Tiranës ishte vijimi dhe kulmi i mësymjes së përgjithshme të UNÇSH-së për çlirimin e Shqipërisë. Luftimet nisën më 29 tetor dhe u zhvilluan në disa drejtime, duke u ashpërsuar gradualisht deri në ditët e fundit të betejës.

Një vend të veçantë në këtë përballje zë **Beteja e Mushqetasë, më 14–15 nëntor 1944**, ku u godit kolona gjermane e komanduar nga koloneli Steyrer. Përplasja në Mushqeta pati rëndësi të veçantë për zhvillimin e operacionit, pasi dobësoi mundësitë e forcave gjermane për të siguruar një tërheqje të qetë dhe për të mbështetur garnizonin e rrethuar në Tiranë. Në fazën përfundimtare të operacionit u përfshinë forca nga **11 brigada partizane**, ndërsa rolin kryesor në luftimet brenda kryeqytetit e mbajti **Brigada e Parë "Hero i Popullit"**. Përmasat e angazhimit tregojnë qartë se çlirimi i Tiranës ishte një operacion i gjerë, ku bashkëvepruan formacione të ndryshme dhe ku koordinimi i veprimeve mori një rëndësi të veçantë.

Sulmi përfundimtar

Pas luftimeve të ashpra të ditëve të para të nëntorit, rrethimi i forcave gjermane në kryeqytet u ngushtua gjithnjë e më shumë. Më 16 nëntor u zhvillua faza përfundimtare e sulmit.Forcat e Brigadës së Parë përparuan në pika të rëndësishme të qytetit dhe morën nën kontroll objekte me rëndësi strategjike, ndër të tjera Shtëpinë e Oficerëve, Sahatin dhe Teatrin. Në drejtim të rrugës së Kavajës përparuan forcat e Brigadës së 8-të, të cilat u lidhën me krahun e djathtë të Brigadës së Parë, duke e ngushtuar më tej unazën rreth forcave armike.



Rezistenca gjermane ishte e ashpër. Forcat pushtuese u mbështetën në pozicionet e fortifikuara në ndërtesat e ministrive, bankave, Bashkisë dhe në hotel "London", në zonën ku sot ndodhet Muzeu Historik Kombëtar.

Luftimet vazhduan gjatë gjithë ditës së 16 nëntorit. Por situata për forcat gjermane po bëhej gjithnjë e më e pashpresë.

Në natën që ndante datën 16 nga 17 nëntori, komanda gjermane, përballë pamundësisë për të mbajtur më tej pozicionet në kryeqytet, vendosi të tërhiqej.

Duke përfituar nga errësira, pjesë të forcave dolën nga rrethimi dhe u grumbulluan në fushën e Aviacionit. Më pas u nisën në drejtim të Vorës dhe Shkodrës. Forcat gjermane që u tërhoqën nga Tirana vijuan të goditeshin gjatë tërheqjes në aksin Tiranë–Vorë–Laç.

Mëngjesi i 17 nëntorit

Në mëngjesin e 17 nëntorit 1944, Tirana ishte e lirë. Pas 19 ditësh e netësh luftimesh të ashpra, kryeqyteti shqiptar doli nga një prej periudhave më të vështira të historisë së tij të luftës. Çlirimi i Tiranës krijoi kushtet dhe besimin për përfundimin e mësymjes së përgjithshme dhe për çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Pas betejës mbeti edhe një bilanc i rëndë njerëzor. Në luftimet për çlirimin e Tiranës dhanë jetën 127 luftëtarë, ndërsa 290 të tjerë u plagosën. Humbjet e forcave pushtuese ishin gjithashtu të mëdha. Sipas të dhënave të periudhës, pati rreth 3000 të vrarë, shumë të plagosur dhe rreth 300 robër. U kapën gjithashtu sasi të konsiderueshme armatimi dhe materiali ushtarak, përfshirë topa, tanke, mitralozë dhe automjete.





Por përtej shifrave dhe bilancit ushtarak, ajo që mbeti ishte një qytet i shpëtuar nga shkatërrimi i plotë që pushtuesit synonin t'i shkaktonin.

Një shembull i artit ushtarak

Luftimet për çlirimin e Tiranës kanë edhe një rëndësi të veçantë për historinë ushtarake shqiptare. Ato dëshmuan përdorimin e një sërë elementësh të rëndësishëm të organizimit dhe drejtimit të veprimeve luftarake: manovrimin, përqendrimin gradual të forcave, bashkëveprimin ndërmjet formacioneve, komunikimin dhe transmetimin e urdhrave përmes radiove, lajmëtarëve dhe kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet shtabeve.

Në fazën përfundimtare, përfshirja e forcave nga 11 brigada krijoi një përqendrim të madh njerëzor dhe operacional, duke mundësuar vijimin e pandërprerë të mësymjes deri në përfundimin e saj.

Në këtë kuptim, beteja e Tiranës nuk ishte vetëm një përballje për marrjen e një qyteti. Ajo ishte një operacion i gjerë ushtarak, ku koordinimi, qëndrueshmëria, manovra dhe përqendrimi i forcave luajtën rol të rëndësishëm në rezultatin përfundimtar.

Tirana e çliruar, një simbol i kujtesës kombëtare

Sot, 82 vjet pas atij nëntori të vitit 1944, 17 Nëntori mbetet një datë e lidhur me kujtesën e Tiranës dhe të Shqipërisë së asaj kohe. Përkujtimi i saj është, mbi të gjitha, një homazh për njerëzit që luftuan dhe ranë në ato ditë të vështira.

Në qendër të kësaj kujtese qëndrojnë dëshmorët, familjet e tyre dhe të gjithë ata që morën pjesë në luftën për çlirimin e vendit.

Monumenti "Partizani i panjohur", një nga simbolet e lidhura me kujtesën publike të çlirimit të Tiranës, mbetet pjesë e hapësirës memoriale të Tiranës dhe e kujtesës së brezave.

17 Nëntori nuk është vetëm një datë në kalendar. Është një ditë që na rikthen te një prej momenteve më të rëndësishme të historisë së Tiranës, te sakrifica njerëzore e një brezi dhe te kujtesa e një kohe kur fati i vendit vendosej nëpër beteja.

Të kujtosh është të mos lejosh që sakrifica të humbasë në harresë. Historia, me dritat dhe plagët e saj, mbetet pjesë e identitetit të një kombi.

17 Nëntor 1944, Tirana u çlirua.

Lavdi dëshmorëve dhe nderim për të gjithë ata që luftuan për çlirimin e kryeqytetit dhe të Shqipërisë!



Inteligjenca Artificiale po mëson të krijojë viruse

Revolucion në mjekësi: Viruse me porosi mund të shkatërrojnë bakteret rezistente



Inteligjenca artificiale ka kaluar tashmë përtej aftësisë për të shkruar tekste, krijuar imazhe apo programuar kode kompjuterike. Sot, ajo po hyn në një territor krejtësisht të ri: projektimin e vetë blloqeve themelore të jetës. Një zhvillim i fundit shkencor, i raportuar nga "The Guardian", "BBC" dhe "The New York Times", ka treguar se modelet e avancuara të inteligjencës artificiale mund të krijojnë kode gjenetike funksionale dhe të projektojnë viruse krejtësisht të reja që nuk kanë ekzistuar kurrë më parë në natyrë.

Për herë të parë, shkencëtarët kanë demonstruar se një sistem i inteligjencës artificiale mund të gjenerojë receta gjenetike të afta për të krijuar viruse funksionale në laborator. Në testet eksperimentale, disa prej këtyre viruseve artificiale arritën të shkatërrojnë baktere të rrezikshme dhe rezistente ndaj antibiotikëve, duke hapur perspektiva të reja për mjekësinë moderne. Megjithatë, ky sukses shkencor ka ngritur njëkohësisht pyetje serioze lidhur me sigurinë biologjike globale dhe rreziqet që mund të sjellë keqpërdorimi i teknologjisë.

Nga chatbot-et te gjenetika

Për shumicën e njerëzve, inteligjenca artificiale lidhet me chatbot-et, motorët e kërkimit ose programet që krijojnë tekste dhe imazhe. Por parimi mbi të cilin funksionojnë këto sisteme është shumë më i gjerë. Në thelb, ato analizojnë sasi gjigante të dhënash për të identifikuar modele dhe për të bërë parashikime të sakta. Kjo aftësi ka filluar të transformojë edhe biologjinë moderne.

Një nga shembujt më të rëndësishëm të viteve të fundit ishte suksesi i sistemeve të AI-së në parashikimin e strukturave tredimensionale të proteinave, një problem që për dekada konsiderohej ndër më kompleksët në biologji. Ajo që më parë kërkonte vite studimi dhe eksperimente laboratorike, tashmë mund të realizohet brenda pak minutash me ndihmën e algoritmeve inteligjente.

Ky zbulim revolucionar përshpejtoi ndjeshëm kërkimet mbi sëmundjet, zhvillimin e ilaçeve dhe biologjinë molekulare. Mbi të gjitha, ai tregoi se inteligjenca artificiale mund të kuptojë dhe të analizojë informacion biologjik po aq efektivisht sa analizon gjuhën njerëzore.

A mund të mësojë AI-ja gjuhën e ADN-së?

Kjo ishte pyetja që ngritën studiuesit.

Nëse një model gjuhësor mund të parashikojë fjalën e ardhshme në një fjali, pse të mos parashikojë edhe "shkronjën" e ardhshme në kodin gjenetik?

ADN-ja funksionon si manuali i ndërtimit të çdo organizmi të gjallë. Ajo përbëhet nga katër njësi bazë kimike, të njohura si nukleotide, të cilat paraqiten me shkronjat A, C, G dhe T. Kombinimi i tyre përcakton gjithçka, nga ndërtimi i qelizave e deri te funksionimi i organeve dhe organizmave të plotë.

Duke analizuar miliarda dhe triliona kombinime të këtyre "shkronjave", inteligjenca artificiale mund të mësojë rregullat sipas të cilave ndërtohet jeta biologjike.

Arritja historike e studiuesve amerikanë

Një ekip studiuesish nga Universiteti "Stanford" dhe "Arc Institute" realizoi së fundmi një eksperiment që mund të konsiderohet historik për biologjinë sintetike.

Për të trajnuar modelin e inteligjencës artificiale, shkencëtarët përdorën sekuenca gjenetike nga miliona organizma të ndryshëm, përfshirë kafshë, bimë, mikrobe dhe viruse. Në total, sistemi analizoi rreth nëntë trilionë nukleotide.

Kjo sasi kolosale informacioni i lejoi modelit të kuptonte mënyrën se si organizohet kodi gjenetik, si krijohen gjenet dhe si funksionojnë ato në organizmat e gjallë. Por pyetja kryesore mbetej ende pa përgjigje: a mund të krijonte modeli vetë një kod biologjik funksional?

Pse u zgjodhën viruset?

Projektimi i një organizmi kompleks, si një kafshë apo një qenie njerëzore, do të kërkonte përpunimin e miliarda nukleotideve dhe mbetet përtej kapaciteteve aktuale të inteligjencës artificiale. Viruset, megjithatë, kanë gjenome shumë më të vogla. Kjo i bëri ato kandidatin ideal për eksperimentin.

Studiuesit u përqendruan te bakteriofagët, viruse që infektojnë bakteret, por që nuk paraqesin rrezik për njerëzit. Këta viruse përdoren prej vitesh në mjekësi si armë kundër infeksioneve bakteriale që nuk reagojnë ndaj antibiotikëve.

700 mijë viruse që nuk kanë ekzistuar kurrë

Rezultatet ishin befasuese.

Modeli i inteligjencës artificiale gjeneroi mbi 700 mijë kombinime të ndryshme gjenetike për bakteriofagë të rinj. Secili prej tyre përfaqësonte një recetë biologjike unike, një virus të mundshëm që natyra nuk e kishte prodhuar kurrë.

Natyrisht, testimi i të gjitha këtyre varianteve ishte i pamundur. Për këtë arsye, studiuesit përdorën filtra kompjuterikë që identifikuan variantet me shanset më të larta për të funksionuar. Në fund, 285 gjenome u përzgjodhën për t'u ndërtuar fizikisht në laborator.

Kur kodi artificial bëhet jetë

Në fazën tjetër, shkencëtarët sintetizuan molekulat e ADN-së njëra pas tjetrës duke përdorur teknika moderne të biologjisë molekulare. Më pas, këto sekuenca u futën në bakteret E. coli.

Nëse receta e krijuar nga inteligjenca artificiale ishte e saktë, bakteret do të fillonin të prodhonin komponentët e virusit dhe gradualisht do të formonin një virus të plotë dhe funksional.

Kjo është pikërisht ajo që ndodhi.

Nga 285 gjenomet e testuara, 16 arritën të prodhonin viruse plotësisht funksionale dhe të afta për të infektuar bakteret e synuara. Edhe pse shumica e modeleve dështuan, suksesi i këtyre 16 rasteve mjaftoi për të provuar se inteligjenca artificiale është tashmë e aftë të krijojë kode biologjike funksionale.

Kur virusi artificial rezulton më efektiv se ai natyral

Një nga aspektet më të habitshme të studimit ishte fakti se disa prej viruseve të krijuara nga kompjuteri u shumuan më shpejt sesa homologët e tyre natyrorë. Analizat gjenetike zbuluan se disa prej tyre ndryshonin ndjeshëm nga çdo lloj virusi i njohur deri më sot.

Kjo sugjeron se inteligjenca artificiale nuk po kopjon thjesht natyrën. Ajo mund të gjejë zgjidhje biologjike krejtësisht të reja, të cilat evolucioni natyror nuk i ka prodhuar ndonjëherë.

Një armë e re kundër superbaktereve

Antibiotikët kanë shpëtuar miliona jetë gjatë shekullit të kaluar, por përdorimi i tepërt i tyre ka krijuar një problem serioz: bakteret po bëhen gjithnjë e më rezistente ndaj trajtimeve ekzistuese.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e konsideron rezistencën ndaj antibiotikëve një nga kërcënimet më të mëdha për shëndetin publik në dekadat e ardhshme. Për të testuar aftësitë e viruseve artificiale, studiuesit krijuan një "koktej" të përbërë nga disa bakteriofagë të projektuar me inteligjencë artificiale.

Rezultati ishte premtues.

Këta viruse arritën të shkatërrojnë lloje të E. coli që kishin zhvilluar rezistencë ndaj viruseve natyrorë. Kjo nënkupton se në të ardhmen mund të bëhet e mundur projektimi i viruseve me porosi për të luftuar baktere specifike, duke krijuar terapi të personalizuara për pacientët. Në teori, mjekët mund të porosisin viruse të rinj sa herë që bakteret evoluojnë dhe bëhen rezistente ndaj trajtimeve ekzistuese.

Ana e errët e revolucionit biologjik

Por aty ku ka potencial të madh, ka edhe rreziqe të mëdha. Demonstrimi se softuerët mund të krijojnë gjenome virale funksionale ka ndezur alarmet në komunitetin ndërkombëtar të sigurisë biologjike. Ekspertët paralajmërojnë se teknologjia që sot përdoret për të luftuar sëmundjet mund, në të ardhmen, të përdoret edhe për qëllime më të errëta.

Ndryshe nga armët tradicionale, teknologjitë biologjike mund të zhvillohen në laboratorë relativisht të vegjël dhe me kosto gjithnjë e më të ulët.

Nëse sistemet e inteligjencës artificiale bëhen gjithnjë e më të afta në projektimin e organizmave biologjikë, rreziku i keqpërdorimit nga aktorë shtetërorë ose grupe kriminale mund të rritet ndjeshëm.

Garancitë e sigurisë

Vetë studiuesit ishin të vetëdijshëm për këto rreziqe. Për këtë arsye, ata ndërtuan masa të shumta sigurie gjatë eksperimentit. Modeli nuk u trajnua me të dhëna që lidhen me viruse që infektojnë njerëzit, kafshët apo bimët. Në vend të kësaj, ai u fokusua ekskluzivisht te bakteriofagët, të cilët konsiderohen të sigurt për njerëzit.

Megjithatë, ekspertët vërejnë se vlerësimi i rrezikut të organizmave krejtësisht të rinj biologjikë është shumë më i vështirë sesa analizimi i patogjenëve të njohur. Kur një organizëm nuk ka ekzistuar kurrë më parë, shkenca nuk disponon precedentë për të parashikuar saktësisht sjelljen e tij.

Një e ardhme plot mundësi dhe pasiguri

Pavarësisht frikës dhe debateve, shumica e shkencëtarëve bien dakord se aftësitë e inteligjencës artificiale në biologji do të vazhdojnë të zhvillohen me ritme të shpejta. Pyetja nuk është më nëse AI-ja do të projektojë organizma biologjikë gjithnjë e më kompleksë.

Pyetja është nëse institucionet, qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare do të arrijnë të krijojnë rregulla, standarde dhe mekanizma mbikëqyrjeje që ecin me të njëjtin ritëm me teknologjinë.

Ndërsa inteligjenca artificiale po mëson gjithnjë e më shumë "gjuhën e jetës", njerëzimi po hyn në një epokë të re, ku kufiri mes biologjisë dhe teknologjisë po bëhet gjithnjë e më i paqartë. Nga njëra anë, kjo mund të sjellë kura për sëmundje që sot konsiderohen të pashërueshme. Nga ana tjetër, mund të krijojë sfida të reja sigurie që bota nuk i ka hasur kurrë më parë.

Për herë të parë në histori, njeriu nuk po zbulon vetëm mënyrën se si funksionon jeta. Ai po fiton aftësinë për ta projektuar atë. Dhe kjo mund të jetë një nga arritjet më transformuese, por edhe më të debatueshme, të shekullit XXI.



BËHU OFICERI I SË ARDHMES!

STUDIO NË AKADEMINË MBRETËRORE USHTARAKE SANDHURST

Një mundësi e veçantë për formimin dhe karrierën tënde ushtarake në Mbretërinë e Bashkuar!

1 KANDIDAT DO TË PËRZGJIDHET

PËR TË NDJEKUR KURSIN BAZË TË FORMIMIT TË OFICERIT TË FORCËS TOKËSORE NË: ROYAL MILITARY ACADEMY SANDHURST - MBRETËRIA E BASHKUAR

14 QERSHOR – 11 GUSHT 2028

PSE TË ZGJEDHËSH SANDHURST?

Formim ushtarak në një nga akademitë më prestigjioze në botë.

Zhvillim profesional sipas standardeve të NATO-s.

Përvojë ndërkombëtare dhe aftësi të avancuara lidershipi.

Një hap i rëndësishëm drejt karrierës si oficer në Forcat e Armatosura.

KUJDES! AFATI I APLIKIMIT

11 DHJETOR 2026

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet pranë Qendrës së Personel Rekrutimit.

Për kriteret e pranimit dhe informacionin e plotë, vizitoni: www.mod.gov.al

Rubrika: Njoftime → Studentë brenda dhe jashtë vendit

LIDERSHIP ▪ DISIPLINË ▪ PËRGJEGJËSI

E ARDHMJA E FORCAVE TË ARMATOSURA FILLON ME TY!

MINISTRIA E MBROJTJES

FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË